



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 341 Akti

Nr. 478 Vendimi
Tiranë, më 25.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|------------------|
| Etleda Çiftja | Kryesuese |
| Roland Ilia | Relator |
| Firdes Shuli | Anëtare |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 24.11.2021, ora 10:55, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Rexhep Karaj**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, ftoi subjektin e rivlerësimit Rexhep Karaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj, i cili nuk ushtroi të drejtën për t'u paraqitur në seancën dëgjimore publike,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 12.11.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Firdes Shuli dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, komisionere Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Rexhep Karaj.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Rexhep Karaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 2.2.2018, e ILDKPKI-së, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Karaj. Gjithashtu edhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar është dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

9. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë në datën 22.10.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për një nga tri kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për kriterin e pasurisë, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

11. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti u njoh me aktet e dosjes në datën 25.10.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave.

12. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare me postë. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 1.11.2021, përpara se të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, vendosi të rihapë hetimet me vendimin nr. 4, datë 4.11.2021, "Për riçeljen e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit z. Rexhep Karaj". Komisioni vlerësoi se duhen kryer hetime të mëtejshme shtesë, në lidhje me këtë subjekt, për sa i përket kriterit të pasurisë.

12.1 Pas kryerjes së veprimeve hetimore të nevojshme, referuar korrespondencës shkresore me instancat ligjzbatuese, Komisioni doli në përfundimin se rezultati i këtyre hetimeve të mëtejshme nuk ndryshonte rezultatin e hetimit përfundimtar të kryer nga Komisioni dhe në përfundim vendosi të të ftojë, z. Rexhep Karaj, në seancë dëgjimore në datën 17.11.2021, ora 10:00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj, u ftua në seancën dëgjimore të datës 17.11.2021, ora 10:00 me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 15.11.2021.

14. Subjekti i rivlerësimit me *e-mail* e datës 17.11.2021, ora 8:35 kërkoj shtyrjen e seancës dëgjimore për motive shëndetësore pa paraqitur një dokument justifikues ligjor. Komisioni,

megjithatë, vendosi që të shtynte seancën për një datë tjetër duke i lenë mundësinë subjektit për të sjellë dokumentin ligjor siç pretendonte në *e-mail*. Pas kërkesës së Komisionit të datës 17.11.2021, subjekti i rivlerësimit nuk sollti dokument mjekësor për të vërtetuar pamundësinë e tij për të marrë pjesë në seancën e datës 17.11.2021. Në këto kushte, Komisioni vendosi që me *e-mail*-in e datës 19.11.2021 të thërras subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore në datën 24.11.2021, ora 10:00

15. Në seancën dëgjimore të datës 24.11.2021, subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit dhe, po në këtë datë, ka dërguar *e-mail*, në orën 9:12, ku njofton mungesën e tij në seancë dëgjimore për motive shëndetësore. Shkaku i mosparaqitjes është arsyeja se subjekti ishte shtruar në spital që në datën 16.11.2021. Po në datën 24.11.2021, ora 9:54, subjekti dërgon një *e-mail* tjetër duke sqaruar se dokumentacionin justifikues për shkakun e mosparaqitjes do ta paraqiste brenda 2-3 ditëve në vijim. Në kushtet kur subjekti për të disatën herë nuk justifikonte në kohë me shkak ligjor prezencën në seancat dëgjimore, Komisioni vendosi që seanca dëgjimore të zhvillohej në mungesë të subjektit të rivlerësimit. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pa praninë e subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në të njëjtën datë të zhvillimit të seancës, në orën 3:49, subjekti ka dërguar përsëri *e-mail* duke kërkuar shtyrjen e seancës të datës 25.11.2021, ora 9:45, “për shpallje vendimi”, ku sqaron se, pasi është njohur nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare se seanca është shtyrë në datën 25.11.2021, ora 9:45, ndodhet i shtruar në spitalin rajonal Peshkopi dhe, për rrjedhojë, është e pamundur që të marrë pjesë apo të dërgojë përfaqësues ligjor. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i subjekti paraqet dokumentin mjekësor – raport për paaftësi të përkohshme me nr. *** regjistri, datë 25.11.2021.

15.1 Duke pasur parasysh faktin që subjekti i rivlerësimit ka pasur gjithë mundësinë për një mbrojtje efektive edhe me përfaqësues ligjor, si dhe duke mbajtur parasysh faktin e mosparaqitjes në kohë dhe me vërtetësi të gjendjes së tij shëndetësore, Komisioni në datën 25.11.2021, shpalli vendimin për subjektin e rivlerësimit Rexhep Karaj.

16. Komisioni për vlerësimin e kriterit të pasurisë mori në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti me shkresën e datës 1.11.2021.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Z. Rexhep Karaj nuk ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke mos u përgjigjur gjithmonë në kohë dhe me vërtetësi, gjatë procedurës së hetimit administrativ, kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Veprimet e tij kanë pasur qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës,

pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

vendosi të mbyllë hetimin për këtë subjekt, duke u bazuar në gjetjet e konstatuara për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

22. Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Rexhep Karaj, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

23. Z. Rexhep Karaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me *numër indeksi **** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private, si vijon:

- DPV-në e vitit 2003;
- DPV-të për vitet 2004 – 2017;
- deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit 84/2016; si dhe
- DPV-të e vazhës së subjektit deklarues E.K (subjekt deklarimi me nr. indeksi ***), duke përfshirë DPV-në para fillimit të detyrës në vitin 2012; DPV-të për vitet 2013 – 2016, si dhe DPV-në pas largimit nga detyra në vitin 2017.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik; si dhe
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

25. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të

paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 2.2.2018, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për periudhën 2003 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve/gjendje *cash*;
- d) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

26. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Apartament banimi, me sip. 76.17 m², në Mat, Bashkia Burrel

1.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë apartament banimi, me sip. 76.17 m², me vendndodhje në Mat, blerë në vitin 2007 nga Enti Kombëtar i Banesave, në bazë të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”. Vlera e blerjes: 524,608 lekë. Pjesa takuese: 83.3 %. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.2 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi pasurinë apartament banimi, me sip. 76.17 m², lagjja ***, Mat, Burrel. Fitimi i pronësisë është realizuar sipas kontratës së shitjes së apartamentit me pagesë të menjëhershme nr. ***, datë 25.1.2007, me palë shitëse EKB-në Dibër dhe palë blerëse shtetasit Rexhep, T, N, E dhe I.K.

1.3 Komisioni konstatoi se kjo pasuri me nr. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në z. k. *** Burrel, Mat, Bashkia Mat, datë 6.9.2017, është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Rexhep Karaj, T.K dhe H.A (K).

1.4 ZVRPP-ja Mat konfirmon në emër të shtetasve Rexhep Karaj, T.K dhe H.A apartament me sip. 76.17 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në z. k. ***, qyteti Burrel, Bashkia Mat dhe kartelën e pasurisë për këtë apartament në bashkëpronësi, sipas kontratës shitje me pagesë të menjëhershme nr. ***, datë 25.1.2007, me vlerë 524,608 lekë, me palë shitëse EKB-në Dibër dhe palë blerëse R, T, N, E dhe I.K.

1.5 Sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit, pagesa e apartamentit është bërë me këste dhe me bono privatizimi.

1.6 Gjatë hetimit për këtë pasuri u konstatuan disa problematika, për të cilat Komisioni i kërkoi sqarime subjektit të rivlerësimit, lidhur me burimet e ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, mundësitë financiare dhe kontributin e secilit pjesëtar të familjes, duke i ndarë sipas viteve përkatëse të kryerjes së pagesave. Gjithashtu, iu kërkua sqarim subjektit se si është

paguar kjo banesë nga dhënia në përdorim në vitin 1995 dhe deri në vitin 2007, vit kur është realizuar privatizimi.

1.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “*Apartamenti është përfituar nga programi për statusin e të pastrehëve, parashikuar nga ligji nr. 8030, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”. Nga viti 1995 deri në vitin 2007, nuk është kryer asnjë lloj pagese për këtë apartament.*

Pagesa është kryer në vitin 2007, me një këst të vetëm, duke i zbritur çmimit fillestar prej 1.317.188 lekësh, pjesën e kontributit të shtetit për familjet e pastreha dhe njëkohësisht 30 % të vlerës për shkak të pagesës së menjëhershme (me një këst pagese të vetme), duke paguar përfundimisht për blerjen e apartamentit, shumën 524.608 lekë”.

1.8 Deklarimi i subjektit për kryerjen e pagesës në vitin 2007 nuk rezultoi i saktë, pasi sipas mandatpagesës së datës 27.12.2006, në “Raiffeisen Bank”¹, pagesa është kryer në vitin 2006.

1.9 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, subjekti ka deklaruar apartament banimi me sip. 90 m², me vlerë 1,300,000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron se bëhet fjalë për të njëjtin apartament të privatizuar nga EKB-ja Dibër. Gjithashtu, subjekti deklaroi se nuk e ka parë kurrë këtë deklaratë periodike, se nuk është bërë nga ana e tij, pasi nuk ka qenë brenda vendit dhe se me dijeninë e tij, kjo deklaratë është bërë nga një koleg i Gjykatës së Rrethit Mat në prani dhe me dijeni të bashkëshortes T.K.

1.10 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në vlerën 524.608 lekë.

1.11 Analiza financiare

Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit nga EKB-ja Dibër, në datën 27.12.2006

| Përshkrimi | Vlera |
|---|------------------|
| Të ardhura Rexhep Karaj, 1.1.2006 - 27.12.2006 | 933,681 |
| Të ardhura T.K, 1.1.2006 - 27.12.2006 | 351,810 |
| Të ardhura pensioni N.K, 1.1.2006 - 27.12.2006 | 36,325 |
| Të adhurua totale, 1.1.2006 - 27.12.2006 | 1,321,816 |
| Shpenzime jetese, 1.1.2006 - 27.12.2006 | 657,342 |
| Shpenzime udhëtimi 1.1.2006 - 27.12.2006 | 86,592 |
| Blerje banese datë 27.12.2006 | 524,608 |
| Shpenzime totale 1.1.2006 - 27.12.2006 | 1,268,542 |
| Kthim borxhi nipit në vlerën 4,000 euro | 494,812 |
| Ndryshim likuiditeti, 31.12.2005 - 27.12.2006 | -620,207 |
| Mundësi kursimi | 178,669 |

1.12 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kishin mundësi financiare për blerjen e pasurisë apartament dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

¹Shihni dokumentin veprim me arkë të “Raiffeisen Bank”, datë 27.12.2006, në përgjigje të ZVRPP-së Mat, në dosjen e ILDKPKI-së.

Në këtë analizë janë zbritur të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit në vlerën 36,325 lekë².

1.13 Por, në përfundimi të hetimit, Komisioni konstatoi mospërputhje në lidhje me vitin e blerjes së kësaj pasurie, pasi subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka blerë këtë pasuri në vitin 2007, ndërkohë që nga dokumentacioni justifikues i administruar gjatë hetimit rezultoi se pagesa është bërë në dhjetor të vitit 2006, si dhe subjektit iu kërkua të japë shpjegime se si një deklaratë periodike e vitit 2004, nuk është plotësuar, nuk është parë asnjëherë prej tij, por është dorëzuar në ILDKPKI me firmën e tij.

1.14 Për gjetjet e mësipërme, subjekti i kaloi barra e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit

1.15 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Kërkoj të mos konsiderohej si mospërputhje, pasi kalimi i pronësisë së apartamentit është bërë nëpërmjet një procesi që ka nisur në vitin 2006 dhe, më pas, me nënshkrimin e kontratës së shitjes e cila është bërë në muajin janar të vitit 2007.*

Pagesa për blerjen e këtij apartamenti është bërë sipas mandatpagesës bankare, datë 27.12.2006, në vlerën 524,608 lekë, e deklaruar si pagesë apo shpenzim në DPV-në për vitin 2006, ndërsa veprimi juridik i kalimit të pronësisë së këtij apartamenti është bërë në vitin 2007.

Nuk bëhet fjalë për deklaratën periodike të vitit 2004, por për deklaratën periodike të vitit 2003. Gjatë kësaj periudhe kam vuajtur nga një sëmundje e rëndë dhe jam trajtuar në Itali. Për të provuar këtë fakt, kam paraqitur një dokument në gjuhën italiane, i cili më është lëshuar nga autoritetet italiane, në zonën e Lombardisë, sipas të cilit unë përfitoja trajtim mjekësor falas pranë spitalit italian”.

Vlerësimi i Komisionit

1.16 Pavarësisht mospërputhjeve në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2007, në lidhje me mos pasqyrimin e saktë të momentit të blerjes së apartamentit, në vlerën 524,608 lekë, Komisioni nuk e konsideron si problematikë për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

1.17 Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit në lidhje me mosnënshkrimin prej tij të DPV-së të vitit 2003, dorëzuar në vitin 2004 (shpjegim i dhënë edhe në vijim në mënyrë të përsëritur), Komisioni e gjeti të pajustificuar dhe të paargumentuar.

1.18 Komisioni e konsideroi të papranueshme argumentin e dorëzimit të një dokumenti në ILDKPKI me emrin dhe nënshkrimin e subjektit, por duke pranuar mosplotësimin e kësaj deklarate prej tij.

1.19 Në këto kushte, Komisioni nuk pranoi kërkesën e subjektit për mosmarrjen në konsideratë të dokumentit DPV/2003.

²Shihni metodologjinë në pikën 23 të këtij vendimit.

1.20 Veprime dhe qëndrime të tilla të subjektit të rivlerësimit, për Komisionin, cenojnë figurën e tij si gjyqtar dhe humbin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

2. Shtëpi banimi

2.1 Subjekti ka deklaruar pasuri shtëpi banimi në ***, K, me sip. 208 m² dhe truall 300 m². Trashëgimi familjare. Pjesa takuese: 100%. E pavlerësuar.

2.2 Subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri ka paraqitur vërtetim datë 10.12.2014, nga Komuna ***, ku deklarohet se shtetasi Rexhep R Karaj, lindur në fshatin *** ka në pronësi pasurinë nr. ***, në Komunën ***, me sip. 300 m², z. k. ***, të fshatit *** dhe një shtëpi 2-katëshe me sip. 208 m².

2.3 ZQRPP-ja dhe ZVRPP-ja Mat nuk e konfirmojnë këtë pasuri “shtëpi banimi” në emër të subjektit Rexhep Karaj.

2.4 Gjatë hetimit subjektit të rivlerësimit (meqë e ka deklaruar si trashëgimi familjare), iu kërkua nga Komisioni të deklarojë dhe të paraqesë dokumentacion të plotë lidhur me fitimin e të drejtës së trashëgimisë mbi pasurinë e cituar.

2.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Shtëpia e banimit është një banesë e ndërtuar në vitin 1928, dykatëshe, që ndodhet në fshatin tim të lindjes (origjina ime dhe e familjes time), pasuri e prindërve të mi, të cilët aktualisht nuk jetojnë, babai ka vdekur në vitin 1987, ndërsa nëna në vitin 2011. Duke qenë djalë i vetëm i prindërve të mi, bashkë me një motër, e cila është e martuar që në vitin 1967, banesa në fjalë është trashëgimi, për shkakun e rrethanave sa sipër. Bashkëlidhur kam sjellë vërtetimet nga komuna *** dhe nga zyra vendore e kadastrës Mat. Në kuadrin e regjistrimit dhe azhornimit të tokës bujqësore, banesa është regjistruar si pasuri e familjes time bashkë me një truall me sip. 300 m²”.*

2.6 Krahas vërtetimit të lëshuar më 10.12.2014 nga ish-kryetari i komunës *** Mat, subjekti i rivlerësimit sjell edhe një vërtetim me nr. *** prot., datë 20.5.2021, nga Zyra Vendore e Kadastrës Mat, ku thuhet se shtetasi Rexhep Karaj ka të regjistruar pasurinë arë+truall me sip. 300 m² truall dhe 96 m² ndërtesë, në z. k. ***, fshati ***, Mat. Ky i fundit citon shtëpinë 96 m² dhe jo 208 m², si në vërtetimin më sipër.

2.7 Subjekti i rivlerësimit nuk solli prova të mjaftueshme për të vërtetuar pronësinë mbi pasuritë shtëpi dhe truall dhe as informacion për përfitimin përdorimin, zhvillimin dhe investimet, që mund të jenë bërë përgjatë viteve të shkuara në këtë pasuri truall dhe shtëpi banimi.

2.8 Për Komisionin mbetet e paprovuar mënyra e përfitimit të shtëpisë së banimit me sip. 208 m² dhe truallit me sip. 300 m², në fshatin ***, Bashkia Klos. Nëse deklarimet e subjektit për përfitimin e kësaj pasurie me anë të trashëgimisë, sipas Kodit Civil, e drejta e trashëgimisë njihet në dy forma: (i) ligjore; dhe (ii) me testament. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument provues për përfitimin e kësaj prone me trashëgimi. Rezulton nga përbërja familjare se subjekti Rexhep Karaj të ketë edhe një motër, por që nuk paraqet as dokument çelje trashëgimie dhe as deklaron pjesë ligjore të motrës së tij, pavarësisht disponimit real që ka dhe mund të ketë motra e tij.

2.9 Për Komisionin rezultoi e paqartë gjendja reale e kësaj ndërtese, viti i ndërtimit, (rikonstruksione të kryera), mënyra e përfitimit të saj, si dhe investime shtesë, ndër vite, nga subjekti. Për të gjitha këto gjetje, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit përsëri në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, vitin përkatës, vlerat e investimeve të kryera të ndara sipas viteve.

2.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar nga Komisioni. Komisioni i dërgoi subjektit pyetësorin nr. 3 duke i lënë afat deri në datën 7.10.2021. Subjekti i rivlerësimit për arsye personale kërkoi kohë, e cila iu akordua nga Komisioni duke i caktuar afat të ri deri në datën 12.10.2021 për kthimin e përgjigjeve. Subjekti kërkoi përsëri kohë dhe nuk ktheu përgjigje për pyetësorin nr. 3. Mos përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin, Komisioni e vlerësoi edhe në vendimmarrjen e tij, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2.11 Duke qenë se subjekti nuk ktheu përgjigje për pyetësorin, në lidhje me dokumentacionin provues të kërkuar, në këto rrethana, Komisioni u bazua vetëm në provat dhe faktet e administruara dhe arriti në konkluzionin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi.
- b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar origjinën e krijimit të pasurisë, mënyrën e fitimit të pronësisë, statusin aktual, investimet e kryera dhe periudhat e kryerjes së tyre,
- c) Subjekti nuk arriti të provojë burimin e krijimit të kësaj pasurie që rrjedh nga trashëgimia (sipas deklaramentit të subjektit), si dhe kohën e ndërtimit të kësaj pasurie.
- d) Ka mospërputhje në lidhje me sipërfaqen ndërtimore të kësaj pasurie, midis deklaratës *Vetting* të vitit 2017 dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, pasi subjekti deklaroi se ka ndërtesë me sip. 208 m², ndërkohë që sipërfaqja e objektit nga hetimi i Komisionit rezultoi 96 m².
- e) Subjekti duhet të paraqesë dokumentacion provues lidhur me kundërshtimin e gjetjeve të Komisionit dhe ftohet që të paraqesë dhe dokumentacion fotografik (foto të gjendjes aktuale) të objektit ndërtimor.

2.12 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

2.13 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Nuk kam pasur asnjë arsye se përse duhet të fshih origjinën dhe mënyrën e fitimit të kësaj prone. Bëhet fjalë për një objekt 100- vjeçar dhe për një sipërfaqe toke që zotërohet prej 3 apo 4 brezash tashmë nga familja jonë.*

Fitimi i pronësisë është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Regjistrimi i shtëpisë është bërë në emrin tim bazuar në Formularin e Trojeve dhe Shtëpive . Këtë shtëpi e zotëroj unë me familjen time.

*Për të provuar mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, ju vë në dispozicion dokumentet e origjinës së kësaj pasurie që janë përcjellë përmes shkresës nr. *** prot., datë 26.10.2021, me objekt “informacion”, lëshuar nga ASHK-ja, Zyra Vendore Mat.*

Sqaroj se shtëpia është 2-katëshe dhe se sipërfaqja 96 m² i përgjigjet vetëm katit të parë. Këtë e provoj me fotografitë e shtëpisë bashkëngjitur përgjigjeve.

*Për sa i përket deklaramit në deklaratën Vetting ky deklaram është bërë në bazë të dokumentit zyrtar “vërtetim i datës 10. 12.2014 të lëshuar nga komuna ***.*

Aktualisht shtëpia është e amortizuar, pasi në këtë shtëpi unë nuk kam bërë asnjë investim dhe kjo pasqyrohet më së miri edhe me fotografitë përkatëse të bëra tani në këtë periudhë”.

2.14 Pas dërgimit të shpjegimeve përfundimtare nga subjekti i rivlerësimit, për shkak të mosparaqitjes së dokumentacionit të plotë provues, por edhe dyshimeve të anëtarëve të Komisionit, në lidhje me pasurinë shtëpi banimi me sip. 208 m² dhe truall me sip. 300 m², në fshatin ***, Bashkia Klos, Komisioni vlerësoi se duhen kryer hetime të mëtejshme shtesë në lidhje me këtë subjekt, për sa i përket kriterit të pasurisë.

2.15 Për këtë qëllim, trupi gjykues me vendimin nr. 4, datë 4.11.2021, vendosi “për riçeljen e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj”.

2.16 Pas kryerjes së veprimeve hetimore të nevojshme, referuar korrespondencës shkresore me instancat ligjzbatuese, Komisioni doli në përfundimin se rezultati i këtyre hetimeve të mëtejshme nuk ndryshonte rezultatin e hetimit përfundimtar të kryer nga Komisioni.

Vlerësimi i Komisionit

2.17 Vendimi nr. ***, datë 23.8.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat “për lëshimin e trashëgimisë ligjore të të ndjerit R.K”, përcakton trashëgimtarët që janë përkatësisht ish-bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij H.A (K) dhe Rexhep Karaj. Ky dokument ishte kërkuar me kohë nga Komisioni dhe nuk është vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit gjatë fazës së hetimit administrativ.

2.18 Shpjegimet e subjektit nuk përkojnë me vendimin e gjykatës për lëshimin e trashëgimisë ligjore. Subjekti nuk paraqiti dokumentacion tjetër për të provuar deklaramet e tij se prona është e trashëguar vetëm në emër të tij dhe të familjes së tij, duke mos përfshirë ligjërisht motrën H.A (K). Komisioni e konsideron deklaram të pasaktë përftimin vetëm nga ana e tij të kësaj pasurie duke vetëpërshtuar trashëgimtarët e tjerë ligjore.

2.19 Pas kërkesës së bërë nga Komisioni, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti vuri në dispozicion *ortofotot* e pasurisë truall dhe shtëpi banimi, në fshatin ***, Bashkia Klos, Mat. Nga këto prova të administruara nuk lindën dyshime për pasurinë e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

2.20 Në përfundim, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës janë bindëse dhe nuk kanë pasur si qëllim fshehjen e kësaj pasurie.

2.21 Për sa më sipër, duke parë edhe shpjegimet e subjektit, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti nuk ka qenë bashkëpunues për të kthyer përgjigje në kohë pyetjeve të Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit.

3. Tokë bujqësore, me sip. 36.846 m², në fshatin *, Bashkia Klos**

3.1 Subjekti ka deklaruar tokë bujqësore me sip. 36.846 m², sipas vërtetimit të lëshuar nga ZAMT-ja (posedim pa titull), si trashëgimi familjare, me adresën ***, Bashkia Klos, pjesa takuese 100%, e pavlerësuar.

3.2 Sipas vërtetimit të Këshillit të Qarkut Dibër, datë 24.10.2017, vërtetohet se në bazë të dokumenteve kadastrale të viteve 1950-1952, shtetasi R.K nga fshati *** disponon 36.846 m², tokë e ndarë në ngastra të ndryshme dhe me skica.

3.3 ZQRPP-ja dhe ZVRPP-ja Mat nuk e konfirmojnë këtë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit.

3.4 Gjatë hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua nga Komisioni të deklarojë dhe të paraqesë dokumentacion të plotë lidhur me fitimin e të drejtës së trashëgimisë mbi pasurinë e cituar.

3.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Toka bujqësore ka qenë pasuri e familjes time, e trashëguar brez pas brezi dhe për këtë ka dokumente provuese, të cilat do t’i gjeni bashkëngjitur këtyre përgjigjeve. Në bazë të një situatë dhe rrethanave ekstra ligjore, pas shpërbërjes së ish-kooperativave bujqësore në qershor të vitit 1991, në shumicën e fshatrave të rrethit Mat edhe në fshatin tim ***, secili prej fshatarëve të fshatit tim, u vendos në zotërim me titull e pa titull të ish-pronave të veta. Pjesë e kësaj sjelljeje ka qenë dhe familja ime. Duke qene se toka që ishte pasuri e familjes time, mbeti e lirë dhe jashtë kujdesit të shtetit, jam vënë në posedim të kësaj pasurie, sigurisht pa pasur një titull ligjor, siç do të ishte gjëja më e mirë, me normale dhe më e drejta. Gjatë viteve në vijim, kam bërë përpjekje për të rregulluar raportet e duhura ligjore me këtë pasuri, por një gjë e tillë ka filluar në vitin 2020, bazuar në ligjin nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, kryesia e fshatit ***, me vendimin nr. ***, datë 6.10.2020, ka miratuar në favorin tim, të drejtën e regjistrimit të kësaj toke, deri tani në përdorim. Regjistrimi i kësaj pasurie nuk është finalizuar akoma, pasi ndodhet për vlerësim në Drejtorinë Vendore të Kadastrës Dibër”.*

3.6 Bashkëngjitur përgjigjes së pyetësorit subjekti paraqet vendimin nr. ***, datë 6.10.2020, të Kryesisë së fshatit *** dhe plan-rilevimet përkatëse.

3.7 Por, për Komisionin mbeti e paprovuar mënyra e përfitimit të tokës bujqësore me sip. 36.846 m², në fshatin ***, Bashkia Klos, deklaruar e përfituar me trashëgimi. Gjithashtu, nuk dokumentohej dhe sqarohej nëse kjo tokë bujqësore është punuar dhe investuar, ndër vite, për këtë pasuri.

3.8 Subjekti u pyet nëse kjo tokë bujqësore është punuar e investuar dhe se si janë ndarë në vite të ardhurat e përfituara.

3.9 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar nga Komisioni³.

³Shihni konstatimet e bëra nga Komisioni në pikën 2.10, më sipër në rezultatet e hetimit

3.10 Duke qenë se subjekti nuk ktheu përgjigje për pyetësoin, në lidhje me dokumentacionin provues të kërkuar, në këto rrethana, Komisioni u bazua vetëm në provat dhe faktet e administruara dhe arriti në konkluzionin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.
- b) Nuk rezultoi akt fitimi i pronësisë apo akte të trashëgimisë, për këtë pasuri, e cila nuk figuron e regjistruar në ASHK.
- c) Subjekti nuk i është përgjigjur Komisionit lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe investimin e kryer ndër vite.

3.11 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

3.12 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Në lidhje me përfundimin e Komisionit mendoj se është me vend që të vlerësohet ‘posedim pa titull’, i cili tregon se deri në momentin që unë kam bërë deklarinimin, posedimit tim i ka munguar një dokument ligjor në përputhje me ligjin. Kjo është arsyeja që unë kam përdorur termin ‘posedim’ dhe aq me tepër ‘pa titull’. Kjo situatë ka ndryshuar me miratimin e ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën Shqipërisë”, i cili ka sjellë ndryshimin e pozitës time juridike karshi pronave që kam patur në posedim.*

*Sipas këtij ligji, kryesia e fshatit ***, me vendimin nr. ***, datë 6.10.2020, ka miratuar në favorin tim, të drejtën e regjistrimit të kësaj toke, deri tani në përdorim nga unë.*

Kjo pronë është trashëguar nga babai im R.K dhe është fituar me trashëgimi familjare.

*Sikurse vërtetohet me vërtetimin, datë 24.10.2007, të Këshillit të Qarkut Dibër, zyra e AMT-së, në bazë të dokumenteve kadastralë të viteve 1950-1952, z. R.K, disponon 36.846 m² tokë sipas ngastrave të ndryshme dhe kufijtë e tokës, të mirëpërcaktuara. Unë si trashëgimtar ligjor i babait tim, sipas vendimit nr. ***, datë 23.8.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, lëshim i aktit të trashëgimisë ligjore për të ndjerin R.K, e zotëroj këtë tokë që në vitin 1991.*

Ndërsa për sa i përket investimit të kryer në këtë sipërfaqe toke, deklaroj se nuk kam kryer asnjë investim”.

Vlerësimi i Komisionit

3.13 Trupi gjykues arriti në përfundimin se gjatë procesit të rivlerësimit subjekti nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumente ligjore të kërkuara nga Komisioni (subjekti nuk i është përgjigjur pyetësorit nr. 3).

3.14 Komisioni arriti në përfundimin se subjekti argumentoi se kjo pasuri nuk është pasuri e fshehur dhe është e deklaruar si pasuri e tij.

4. Automjet tip “Mercedes-Benz”

4.1 Subjekti ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz”, më targa ***, i cili është blerë në vlerën 2.500 euro, në vitin 2010. Vlera e zhdoganimit: 331.383 lekë. Pjesa takues: 100%.

4.2 DPSHTRr-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 9.8.2017 dhe datë 24.7.2017, konfirmon se subjekti Rexhep Karaj ka në bashkëpronësi me shtetasin A.R.K automjetin me targa AA *** AU. Kjo sipas deklaratës verbale të shitjes së automjetit në datën 10.12.2010 me palë shitëse A.N dhe palë blerëse Rexhep Karaj për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, në vlerën 2.500 euro, me kontratë dhurimi me nr. ***, datë 19.7.2011, ku Rexhep Karaj i dhuron A.K, 50% të pronësisë së automjetit.

4.3 Certifikata e pronësisë së automjetit me targa AA *** AU (me dokumentacionin teknik përkatës) është regjistruar në emër të shtetasve A.K dhe Rexhep Karaj, sipas deklaratës verbale të shitjes, datë 10.12.2010, me palë shitëse A.N dhe palë blerëse Rexhep Karaj, të automjetit tip “Daimler Chrysler”, në shumën 2.500 euro. Deklarata doganore është në datën 19.12.2010, me vlerë takse të paguar 331.383 lekë.

4.4 Referuar deklaratës doganore për këtë automjet⁴, vlera e llogaritur për efekt tatimit (baza e tatueshme) është më e lartë se vlera e deklaruar për blerjen e kësaj pasurie dhe duket se kjo pasuri është blerë me çmim preferencial ose nuk është deklaruar vlera e saktë për blerjen e saj (kjo dhe në mungesë të kontratës së shitjes).

4.5 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti ka deklaruar autoveturë tip “Mercedes-Benz”, blerë me të ardhurat personale familjare në vlerën 5.500 euro. Ky deklarim nuk përputhet me vlerën e blerjes 2.500 euro dhe 331.383 lekë taksë zhdoganimi. Gjithashtu, nuk paraqitet një kontratë noteriale për blerjen e automjetit, çka vuri në dyshim edhe vlerën reale të tij. Në analizën financiare është përfshirë vlera 5,500 euro, sipas deklarimit të subjektit në DPV-në e vitit 2010, plus vlera e zhdoganimit prej 331.383 lekë.

4.6 Analiza financiare

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, në datën 19.12.2010

| Përshkrimi | Vlera |
|--|------------------|
| Të ardhura Rexhep Karaj, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 1,174,103 |
| Të ardhura T. K, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 489,212 |
| Të ardhura E. K, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 512,876 |
| Të ardhura pensioni N.K, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 65,034 |
| Të ardhura totale 1.1.2010 - 19.12.10 | 2,241,225 |
| Shpenzime jetese, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 785,565 |
| Shpenzime udhëtimi, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 27,762 |
| Shpenzime qiraje, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 120,000 |
| Blerje automjeti, datë 19.12.2010 | 1,093,958 |
| Shpenzime totale, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 2,027,285 |
| Ndryshim likuiditeti, 31.12.2009 - 19.12.2010 | -387,340 |
| Mundësi kursimi | 601,280 |

⁴Shihni dokumentin e paraqitur nga DPSHTRr-ja në dosjen e Komisionit.

Nga analiza financiare, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi të blejnë automjetin dhe të mbulojnë shpenzimet e tjera të periudhës me burime të ligjshme.

4.7 Komisioni, bazuar në provat dhe faktet e administruara, arriti në konkluzionin se:

- a) Subjekti nuk ka deklaruar saktë vlerën e pasurisë automjetit.
- b) Ka mungesë të dokumentacionit ligjor për fitimin e pronësisë (mungon kontrata e shitjes) dhe vlera reale e blerjes.
- c) Ka mospërputhje të vlerës së blerjes në deklaratën *Vetting* me deklarimin në DPV-në e vitit 2010.
- d) Ka dyshime për vlerën reale të automjetit tip “Mercedes-Benz”, bazuar tek çmimi i referencës së deklaratës doganore të importit të mjetit.

4.8 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

4.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Në lidhje me gjetjen e Komisionit ka një keqkuptim dhe llogaritje të gabuar të vlerës së automjetit. Në DPV-në e vitit 2010, shuma 5,500 euro e deklaruar është shuma totale që unë kam shpenzuar, e cila përbëhet nga vlera e shitjes 2,500 euro, sipas deklarimit verbal të shitjes së datës 10.12.2010, lëshuar pranë sportelit telematik të automobilave, Agjencia Lombardi, me seli në Brescia, Itali. Ky dokument ndodhet në dosjen e automjetit me targa AA *** AU, të cilën Komisioni e ka tërhequr nga DPSHTRr-ja. Në rastin konkret, Komisioni ka gabuar duke i shtuar vlerës 5,500 euro edhe shumën e doganës, gjë e cila ka sjellë rritjen e shpenzimeve në mënyrë artificiale duke ndikuar në analizën vjetore vit pas viti.*

*Në dosjen e automjetit gjendet akti nëpërmjet të cilit unë jam bërë pronar dhe ka të dokumentuar çmimin e blerjes, si dhe të dhënat e tjera. Automjeti “Mercedes-Benz” më targa *** është blerë nëpërmjet aktit të shitjes ‘deklarim verbal i shitjes, datë 10.12.2010’, lëshuar pranë STA, Agjencia Lombardi, ku shitës është shtetasi A.N. rezident në Itali, dhe blerës Rexhep Karaj. Ky dokument ka shërbyer si akt për zhdoganimin e automjetit nga Italia për në Shqipëri direkt në emrin tim dhe për regjistrim në DPSHTRR.*

Për sa kohë që, ky dokument është pranuar nga autoritetet në Itali dhe Shqipëri, do të thotë që nuk ka se si të jetë objekt i një vlerësimi tjetër që nuk mbështetet në ligj.

Sa i takon vlerën reale të blerjes së automjetit, deklaroj se kam blerë një makinë të përdorur prej më shumë se 8 vitesh, kjo makinë ishte prodhim i vitit 2002 dhe kishte nevojë për një sërë shërbimesh për ta sjellë në gjendje optimale. Pas transportit, në Shqipëri kam paguar vlerën e zhdoganimit në shumën 331,383 lekë. Është kjo arsyeja se përse unë kam deklaruar çmimin e blerjes së automjetit në vlerën 5,500 euro, pa dhënë detajet më sipër”.

Vlerësimi i Komisionit

4.10 Komisioni hartoi një analizë të re financiare duke pasqyruar shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve lidhur me vlerën e automjetit. Vlera e automjetit në analizën financiare u konsiderua 5,500 euro dhe, gjithashtu, për shkak të mospërfshirjes së të ardhurave nga pensioni i nënës së subjektit⁵, ka ndryshim në këtë analizë financiare.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, në datën 19.12.2010

| Përshkrimi | Vlera |
|--|------------------|
| Të ardhura Rexhep Karaj, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 1,174,103 |
| Të ardhura T.K, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 489,212 |
| Të ardhura E.K, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 512,876 |
| Të ardhura totale 1.1.2010 - 19.12.2010 | 2,176,191 |
| Shpenzime jetese, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 785,565 |
| Shpenzime udhëtimi, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 27,762 |
| Shpenzime qiraje, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 120,000 |
| Blerje automjeti, datë 19.12.2010 | 762,575 |
| Shpenzime totale, 1.1.2010 - 19.12.2010 | 1,695,902 |
| Ndryshim likuiditeti, 31.12.2009- 19.12.2010 | -387,340 |
| Mundësi kursimi | 867,629 |

Nga analiza financiare, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi të blejnë automjetin dhe të mbulojnë shpenzimet e tjera të periudhës me burime të ligjshme.

4.11 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti argumente për të kundërshtuar rezultatet e hetimit dhe, në përfundim, komisioni konsideroi argumentin e parashtruar nga subjekti në lidhje me vlerën totale të blerjes së automjetit 5,500 euro, ku përfshihet vlera e blerjes dhe e zhdoganimit.

4.12 Komisioni, pas konsiderimit të shpjegimeve të sjella nga subjekti i rivlerësimit, vendosi të rishikojë vlerën e kësaj pasurie në analizën financiare dhe e ndryshoi si më sipër.

4.13 Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

5. Automjet tip “Volkswagen Golf 3”, blerë në vitin 2006

5.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar automjet tip “Volkswagen Golf 3”, blerë në vitin 2006, në vlerën 200.000 lekë dhe vlerë zhdoganimi 231,440 lekë. Pjesë takuese: 100%.

5.2 Subjekti i Rivlerësimit Rexhep Karaj ka lidhur kontratë shitblerje me nr. ***, datë 6.7.2007, me palën shitëse P.P për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf 3”, në vlerën 200,000 lekë. Rezulton që sipas deklaratës doganore të jetë bërë edhe pagesa e vlerës prej 236,350 lekësh dhe vlerë zhdoganimi në datën 6.9.2007.

⁵Shihni metodologjinë lidhur me të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit N.K te pika 23 e këtij vendimi.

5.3 Me kontratën e dhurimit nr. *** datë 15.11.2011, subjekti Rexhep Karaj i dhuron shtetasit A.K (djali i subjektit) 50% të pronësisë së automjetit tip “Volkswagen Golf”.

5.4 DPSHTRr-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 9.8.2017 dhe datë 24.7.2017, konfirmon se subjekti Rexhep Karaj ka në bashkëpronësi me A.R.K automjetin me targa AA *** BO që është me status çrregjistrim i përkohshëm të regjistruar në DRSHTRr-në Peshkopi. Kjo sipas kontratës shitjes së automjetit nr. ***, datë 6.7.2007, me palë shitëse P.P dhe palë blerëse Rexhep Karaj për blerje automjeti “Volkswagen Golf 3”, në vlerën 200.000 lekë, me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 15.11.2011, ku subjekti Rexhep Karaj i dhuron A.K, 50% të pronësisë së automjetit.

5.5 Këtë pasuri subjekti e ka deklaruar në DPV-në për vitin 2007, në ILDKPKI, në vlerën e blerjes prej 450,000 lekësh. Vlera e blerjes së automjetit është llogaritur në shumën prej 450,000 lekësh, sipas deklaramit të bërë nga subjekti në DPV-në e vitit 2007.

5.6 Konstatohet se automjeti është blerë në vitin 2007 dhe jo në vitin 2006, siç deklaroi subjekti në deklaratën *Vetting*, si dhe ka pasaktësi në vlerat e deklaruara për blerjen e kësaj pasurie.

5.7 Analiza financiare

Nga analiza financiare, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf 3”, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës në vlerën -256,524 lekë.

5.8 Komisioni, bazuar në provat dhe faktet e administruara, arriti në konkluzionin se:

- a) Ka mospërputhje në deklarin e vitit të blerjes së automjetit (viti 2006) me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga DPSHTRr-ja (viti 2007).
- b) Ka mospërputhje në deklarime të vlerës së blerjes së automjetit.
- c) Ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë automjet tip “Volkswagen Golf”, për shkak të pamjaftueshmërisë financiare në vlerën 256,524 lekë.

5.9 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

5.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Gjetjet e Komisionit nuk qëndrojnë, pasi janë rrjedhojë e analizës së gabuar financiare, e ardhur kjo edhe si pasojë e interpretimit të gabuar të deklarimeve të mija vit pas viti.*

Makina është blerë në vitin 2007, sipas kontratës së shitjes së konfirmuar nga DPSHTRr-ja. Vlera e saktë e blerjes së kësaj makinë është aq sa është deklaruar në kontratën e shitjes, pra, 200,000 lekë, ndërsa vlera e zhdoganimit është 231,440 lekë. Në shumatore të vlerave të mësipërme del se vlera totale e shpenzuar për këtë makinë është 431,440 lekë. Sa i takon burimeve të ligjshme për blerjen e makinës tip ‘Volkswagen Golf’ sqaroj se nga tabela e

përlllogaritjeve të bëra nga Komisioni rezulton se nuk janë përfshirë gjendja cash dhe kursimet e mija familjare para blerjes së kësaj makine. Përfshirja e gjendjes cash na analizë hedh poshtë konkluzionin e Komisionit në lidhje me aftësinë paguese të cilën e parashtraj: gjendja cash më datë 31.12.2006 është 1,300,000 lekë (shpjegimet për gjendjen cash të vitit 2016 janë më poshtë). Referuar analizës financiare të vitit 2007, me saktësimin e vlerës së shpenzuar për blerjen e automjetit tip ‘Volkswagen Golf’, në vlerën 431,440 lekë, viti 2007 rezulton me mjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj makine”.

Vlerësimi i Komisionit

5.11 Komisioni hartoi sërish analizën financiare të mundësisë së blerjes së automjetit tip “Volkswagen Golf”, për shkak të mospërfshirjes tek të ardhurat e ligjshme të pensionit të nënës së subjektit N.K⁶. Gjithashtu, vlera e automjetit në analizën financiare u konsiderua 450,000 lekë, sipas deklarimit të bërë nga subjekti në deklarimin e kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2007. Kjo vlerë përfshin edhe shpenzimet doganore.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit “Volkswagen-Golf”, në datën 6.7.2007

| Përshkrimi | Vlera |
|---|-----------------|
| Të ardhura Rexhep Karaj, 1.1.2007 - 6.7.2007 | 414,782 |
| Të ardhura T. K, 1.1.2007 - 6.7.2007 | 213,061 |
| Të ardhura totale, 1.1.2007 - 6.7.2007 | 627,843 |
| Shpenzime jetese, 1.1.2007 - 6.7.2007 | 409,860 |
| Shpenzime udhëtimi, 1.1.2007 - 6.7.2007 | 106,401 |
| Blerje automjeti, datë 6.7.2007 | 450,000 |
| Shpenzime totale, 1.1.2007 - 6.7.2007 | 966,261 |
| Ndryshim likuiditeti, 31.12.2006 - 6.7.2007 | -58,140 |
| Pamundësi kursimi | -280,278 |

5.12 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur, nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf 3” dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës në vlerën -280,278 lekë.

5.13 Në lidhje me shpjegimet e subjektit, për përfshirjen e kursimeve cash nga viti 2006, në burimin e blerjes së automjetit, Komisioni vlerëson se këto kursime nuk mund të përfshihen si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit. Subjekti në DPV-në e vitit 2007 nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve cash, të cilat mund të konsideroheshin si burim për blerjen e këtij automjeti. Përkundrazi, në këtë deklaratë, ai deklaroi kursime nga të ardhurat vlerën 150,000 lekë, vlerë e cila në analizën financiare është konsideruar si shtesë kursimesh.

5.14 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë automjet tip “Volkswagen Golf 3”, për shkak të pamjaftueshmërisë financiare në vlerën 280,278 lekë.

⁶Shihni metodologjinë lidhur me të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit N. K në pikën 23 të këtij vendimi

6. Automjet tip “Ford Fiesta”, me targa AA *** KI

6.1 Automjeti tip “Ford Fiesta ***”, viti prodhimit 2004, është blerë në vlerën 204,000 lekë, sipas faturës së shitjes, datë 24.1.2015, me palë shitëse A.K dhe palë blerëse T dhe I.K, sipas kontratës së shitblerjes me datë 24.1.2015 dhe faturës tatimore të shitjes së datës 24.1.2015. Pjesë takuese: 100%. Bashkëlidhur gjendet edhe ekstrakti historik i subjektit A.K me fushë veprimtarie “tregtim, import, eksport automjesh të përdorura”.

6.2 DPSHTRr-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 9.8.2017 dhe datë 24.7.2017, konfirmon se shtetasja T.K ka në bashkëpronësi me I.R.K automjetin me targa AA *** KI. Kjo vërtetohet sipas kontratës së shitblerjes dhe faturës tatimore, datë 24.1.2015, të blerjes së automjetit “Ford Fiesta”, në shumën 204.000 lekë.

6.3 Analiza financiare

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Ford Fiesta”, në datën 24.1.2015

| Përshkrimi | Vlera |
|---|-----------------|
| Të ardhura Rexhep Karaj, 1.1.2015 - 24.1.2015 | 134,558 |
| Të ardhura T. K tek Zyra Arsimore Mat, 1.1.2015 - 24.1.2015 | 43,847 |
| Të ardhura E. K, 1.1.2015 - 24.1.2015 | 81,254 |
| Të ardhura totale, 1.1.2015 - 24.1.2015 | 259,659 |
| Shpenzime jetese, 1.1.2015 - 24.1.2015 | 122,561 |
| Blerje automjeti, datë 24.1.2015 | 204,000 |
| Shpenzime totale, 1.1.2015 - 24.1.2015 | 326,561 |
| Ndryshim likuiditeti, 31.12.2014 - 24.1.2015 | 93,342 |
| Pamundësi kursimi | -160,244 |

Nga analiza financiare, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës dhe shtimin e likuiditeteve.

6.4 Komisioni bazuar në provat dhe faktet e administruara arriti në konkluzionin se:

a) Ka mungesë dokumentacioni nga burime të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip “Ford Fiesta”, pasi subjekti rezultoi në pamjaftueshmëri të burimeve financiare në vlerën 160,244 lekë.

6.5 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

6.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: “Konkluzionet e Komisionit në lidhje me automjetin kanë të njëjtat ‘vese’ si ato të bëra në lidhje me aftësinë paguese në momentin e blerjes së automjeteve të mëparshme dhe, për rrjedhojë, kërkoj që të merren me rezervë dhe të shërbejnë si bazë për kryerjen e një analize të re. Sa i takon burimeve të ligjshme financiare për blerjen e makinës tip ‘Ford Fiesta’, nga tabela e përlllogaritjeve të bëra nga Komisioni, rezulton se nuk janë përfshirë gjendja cash dhe kursimet e mija familjare. Gjendja

cash në datën 31.12.2014 është në vlerën 6,850,000 lekë (shpjegimet përkatëse për gjendje cash të vitit 2014 janë tek deklaratimet e kursimeve cash më poshtë). Referuar analizës financiare të vitit 2015, ky vit rezulton me mjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj makine”.

Vlerësimi i Komisionit

6.7 Subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të kundërshtuar konstatimin e bërë nga Komisioni, në lidhje me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare në vlerën 160,244 lekë, për blerjen e makinës “Ford Fiesta”, në vlerën 204,000 lekë, në vitin 2015.

6.8 Lidhur me pretendimet e subjektit për përfshirjen e gjendjes *cash* si burim për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron⁷. Nga subjekti nuk është deklaruar as në deklaratën *Vetting dhe* as në DPV-në e vitit përkatës përdorimi i gjendjes *cash* si burim për blerjen e kësaj pasurie.

6.9 Komisioni e gjen të pabazë pretendimin e subjektit se analiza financiare e vitit 2015 është pozitive dhe kjo justifikon blerjen e automjetit. Lidhur me këtë sqarohet se analiza e mundësisë së blerjes së një pasurie bëhet deri në momentin e blerjes së saj. Rezultati i kësaj analize nuk lidhet me rezultatin e vitit 2015.

6.10 Subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri.

7. Huadhënie shoqërisë “**” sh.p.k.**

7.1 Subjekti ka deklaruar huadhënie shoqërisë “****”, sh.p.k., në vlerën 50,000 euro, me administrator Q.D, sipas kontratës nr. ***, datë 31.12.2016. Të ardhura të krijuara nga kursime familjare. Pjesa takuese: 100%.

7.2 Subjekti deklaron se me kontratën e huas nr. ***, datë 31.12.2016, i ka dhënë hua palës huamarrëse shoqërisë “****” sh.p.k., shumën 50,000 euro, me qëllim kalimin në të ardhmen në favor të palës huadhënëse pronësinë e një apartamenti që do të ndërtohet nga huamarrësi në truallin me sip. totale prej 1873.15 m² në pronësi të familjeve B, Xh, Sh etj., ndodhur në z. k. ***, Tiranë, me të cilët shoqëria ka lidhur më parë kontratat e sipërmarrjeve. Afati i kësaj huaje është 2 vjet, afat brenda të cilit shoqëria merr përsipër të përfundojë procedurat për pajisjen me leje ndërtimore për zhvillimin e pronës ku do të ndërtohet apartamenti.

7.3 DPPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2017, konfirmon se subjekti Rexhep R Karaj ka raportime të kontratave noteriale për këtë shtetas: “Në datën 31.12.2016, ka deklaruar se i ka dhënë hua vlerën 50,000 euro, palës huamarrëse shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***”.

7.4 Në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit deklaron se i ka dhënë hua shoqërisë “****” sh.p.k., shumën 50,000 euro me qëllim kalimin në të ardhmen në favor të palës huadhënëse pronësinë e një apartamenti që do të ndërtohet nga huamarrësi në truallin me sip. 1873.15 m² në pronësi të familjeve B, Xh, Sh etj.

⁷Lidhur me trajtimin e kursimeve *cash* referojuni pikes 21 të këtij vendimi.

7.5 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “Huadhënie shoqërisë ‘****’ sh.p.k., shumën 50,000 euro, me administrator Q.D, sipas kontratës nr. ***, dt. 31.12.2016. Afati kësaj huaje është 2 vjet”.

7.6 Gjatë hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua nga Komisioni të deklarojë dhe të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor të plotë lidhur me mundësitë financiare për dhënien e kësaj huaje dhe të sqarojë lidhur me mënyrën e kalimit të shumës prej 50.000 euro shoqërisë ‘****’ sh.p.k., si dhe pritshmëritë konkrete, në lidhje me sipërfaqen dhe vlerën totale të apartamentit, që do të përfitohet në të ardhmen subjekti, si dhe nëse para vitit 2016 dhe në vazhdim kishte pasur ndonjë çështje gjyqësore me shoqërinë ‘****’ sh.p.k., ortakët ose administratorin e kësaj shoqërie?

7.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Administratori i shoqërisë ‘****’ sh.p.k., me administrator Q.D është një person me origjinë nga fshati D, rrethi Mat, me të cilin jemi miq të mirë dhe i kam dhënë hua shumen prej 50,000 euro. Nga ana e huamarrësit Q.D, më është premtuar një sipërfaqe ndërtimore 100 m² në një pallat që ai mendonte ta ndërtonte në vijim. Kanë kaluar shumë vite, por në të vërtetë pallati në të cilin më është premtuar sipërfaqja prej 100 m², është drejt përfundimit. Nga ana e huamarrësit më është ofruar një apartament prej 93 m² (2+1), por që akoma nuk e kam finalizuar me kontratë konkrete. Njëri nga shkaqet pse nuk është finalizuar/formalizuar kontrata e shitjes, nuk ka të bëjë aq shumë me shitësin (edhe pse nga ana e tij më është ofruar një apartament me 7m² më pak nga sa ai më kishte premtuar (100 m²), por shkak kryesor i mosnënshkrimit të kontratës shitjes, ka të bëjë kryesisht me dinamikat e familjes time, duke qenë se tani nga situata e krijuar dhe që lidhet me ndryshimet e gjendjes civile të secilit prej fëmijëve, ka diktuar rrethana e nevoja të reja për tu strehuar dhe që lidhen kryesisht me djalin. Po mendojmë që të kontraktoj një apartament më të vogël për mua dhe bashkëshorten time (apartament 1+1) dhe pjesën tjetër duke i shtuar edhe vlerën e lekëve të përfituara nga shitja e apartamentit tim në qytetin e Burrelit, të mund ta përdor për nevoja strehimi për djalin A.K.*

Për sa i përket mënyrës së kalimit të kësaj shume, deklaroj se ajo është bërë duke ia dorëzuar atij në dorë shumën në fjalë.

Për sa i përket pyetjes për mundësitë financiare të dhënies së kësaj huaje, dua të deklaroj se kjo shumë rezultoi e krijuar nga kursimet e mia familjare dhe është veprimi juridik i vetëm i kësaj natyre dhe i këtyre përmasave. Me kursimet e të gjithë familjes time kam paguar një apartament në Burrel në vitin 2007 (rreth 5-6 milionë lekë të vjetra, saktësisht do e bëj të ditur shumën në vijim) dhe kjo huadhënie e realizuar për qëllimet sa sipër (nevoja strehimi).

*Deklaroj se as para vitit 2016 dhe as pas këtij viti, nuk kam pasur çështje gjyqësore me shoqërinë ‘****’ sh.p.k., as ortakët e as administratorin e kësaj shoqërie.*

Dua të shtoj që para disa muajsh jam ngarkuar me short të gjykoj administratorin e shoqërisë Q.D, për një vepër penale, por kam dhënë dorëheqje, duke mos e gjykuar atë, e në të njëjtën mënyrë do veproj edhe për një tjetër çështje civile, të cilën jam ngarkuar ta gjykoj”.

7.8 Kontrata e huas së datës 31.12.2016 përmban deklarinë e dhënies së shumës 50,000 euro nga subjekti të shoqëria. Objekti i kontratës sipas nenit 1 është dhënia e huas në shumën prej 50,000 euro me qëllim kalimin në të ardhmen në favor të subjektit të një apartamenti që

do ndërtohet nga huamarrësi në Tiranë. Kjo kontratë huaje duket se nuk është sipas formës që përcakton Kodi Civil për kontratat e huadhënies.

7.9 Subjekti nuk ka provuar kthimin e huas apo përfitimin e mundshëm të sipërfaqes ndërtimore të pretenduar edhe pse ka kaluar afati i dhënies së kësaj huaje që nga viti 2016 deri më sot. Subjekti nuk ka provuar pretendimin për përfitimin e një apartamenti në këmbim të shumës së huas, pasurinë reale të përfituar apo sipërfaqen e saj. Të gjitha pretendimet e subjektit mbetet në kuadrin deklarativ.

7.10 Subjekti i rivlerësimit u pyet përsëri në lidhje me huadhënien e shumës 50,000 euro dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj në mënyrë të detajuar (të ardhura nga kursimet vjetore të atij viti; depozitat bankare; gjendja *cash*, etj.).

7.11 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar nga Komisioni⁸.

7.12 Analiza financiare

Subjekti, në DPV-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si burim të kësaj huadhënieje kursimet familjare.

Nga llogaritja e kursimeve *cash* në analizën financiare⁹ gjendja progresive e këtyre kursimeve në fund të vitit 2015 është 0 (zero) lekë dhe, si rrjedhim, kjo nuk mund të shërbejë si burim për huadhënien e deklaruar.

Megenëse huadhënia është deklaruar në datën 31.12.2016, si analizë financiare e mundësisë së dhënies së kësaj huaje, është vetë analiza financiare e vitit 2016.

| PËRSHKRIMI | 2016 |
|---|------------------|
| PASURI | 6,310,652 |
| Huadhënie shoqërisë “***”, në vlerën 50,000 euro, në vitin 2016 | 6,763,500 |
| Ndryshim në likuiditet | -452,848 |
| DETYRIME | 0 |
| PASURI NETO (PASURI - DETYRIME) | 6,310,652 |
| TË ARDHURA dokumentuar | 3,189,877 |
| Të ardhura nga pagat subjekti Rexhep Karaj | 1,506,388 |
| Të ardhura nga pagat bashkëshortja T.K | 594,002 |
| Të ardhura nga pagat vajza E.K | 671,875 |
| Të ardhura nga pagat vajza I. K | 346,968 |
| Të ardhura nga puna djali A. K | 70,644 |

⁸Shihni konstatimet e bëra nga Komisioni në pikën 2.10 më sipër në rezultatet e hetimit.

⁹Shihni trajtimin e kursimeve *cash* në pikën 21 të këtij vendimit.

| | |
|------------------------------|-------------------|
| SHPENZIME | 1,416,241 |
| Shpenzime jetese | 1,175,460 |
| Shpenzime udhëtimi | 240,781 |
| | |
| Pamundësia financiare | -4,537,016 |

Nga kjo analizë financiare, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për dhënien e huas në fund të vitit dhe përbalimin e gjithë shpenzimeve të tjera të vitit.

7.13 Duke qenë se subjekti nuk u përgjigj pyetësorit, në lidhje me dokumentacionin provues të kërkuar, në këto rrethana, Komisioni u bazua vetëm në provat dhe faktet e administruara dhe arriti në konkluzionin se:

- Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për dhënien e huas në shumën 50,000 euro, në vitin 2016, pasi subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë në pamundësi financiare për vitin 2016 në vlerën 4,537,016 lekë.
- Subjekti rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë huaje për dhënien e shumës 50,000 euro, duke u përpjekur të fshehë qëllimin e vërtetë të këtij transaksioni, i cili në përmbajtje duket qartazi që është pagesa për porosinë e këtij apartamenti.
- Subjekti, me vlerën e huas prej 50,000 euro, do të përfitonte një apartament me sip. 100 m², në z. k. ***, por referuar vlerës së tregut, çmimi për këtë apartament llogaritet në shumën 9,700,000 lekë.
- Nuk ka dokumentacion provues (transaksion banke, mandat ose ndonjë formë tjetër të parashikuar nga ligji), që vërteton dhënien shumës prej 50,000 euro shoqërisë “****” sh.p.k., në vitin 2016.

Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri.

7.14 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

7.15 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Gjetjet e Komisionit, në lidhje me aftësinë financiare për të dhënë hua 50,000 euro, janë pasojë e një interpretimi të pasaktë dhe keqkuptimi të deklaratës së vitit 2014.*

Bazuar në deklaramet vjetore të mijat për vitet 2004-2016, parashatroj se kam pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për dhënien e huas prej 50,000 euro në vitin 2016. Konkluzioni i Komisionit për pamundësinë financiare rezulton se ka ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të DPV-së së vitit 2014, ku kursimet e vitit 2014 janë konsideruar si gjendje cash progresive, a thua se kjo ishte shuma e vetme që unë e familja ime kemi kursyer cash në 25 vjet punë.

Sipas tabelës, analiza progresive e kursimeve cash bazuar në DPV-të e subjektit deri në vitin 2013 rezulton gjendje e akumuluar cash në vlerën 6,050,000 lekë dhe kjo vlerë është konkluduar duke u bazuar në dpv-të e mija prej vitit 2004 deri në vitin 2016.

Rezulton se në DPV-në e vitit 2014 për gjendjen cash, kam deklaruar gjendje cash në vlerën 800,000 lekë, vlerë e cila është kursim nga të ardhurat e mija familjare për vitin 2014, që i shtohet gjendjes që unë kam patur deri në vitin 2014.

Në analizën e Komisionit rezulton një keqkuptim i shprehjes 'gjendje cash', duke e konsideruar si total progresiv dhe, për rrjedhojë, duke arritur gabimisht në përfundim për gjendjen cash në vlerën 800,000 lekë (zbritur 5,250,000 lekë). Ndërkohë që vlera prej 800,000 lekë i duhej shtuar gjendjes cash të akumuluar deri në vitin 2013, duke e çuar gjendjen progresive të cash-it në datën 31.12.2014 në vlerën 6,850,000 lekë. Referuar edhe analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezulton një suficit financiar i përlllogaritur prej 6,250,922 lekësh në vitin 2014, duke shënuar një zbritje të menjëhershme prej 5,250,000 lekë në gjendjen familjare të kursimeve cash, ndërkohë që viti 2016 rezulton me një deficit financiar prej 4,537,016 lekësh, po sipas llogaritjeve të kryera nga komisioni.

Informoj se është e pamundur dhe e padeklaruar nga ana ime të kem kryer një shpenzim apo investim të tillë prej 5,250,000 lekësh në vitin 2014 dhe bëj me dije se në DPV-në e vitit 2014 me termin e përdorur 'gjendje cash – 800,000 lekë', kam nënkuptuar shtesën e kursimeve cash familjare të këtij viti, si deklaruar edhe në çdo vit paraardhës prej meje.

Në vitin 2014 nuk ka asnjë shpenzim apo investim të kryer nga ana ime gjë e bën të pamundur reduktimin drastik të kursimeve të mija familjare cash në këtë vlerë.

Në të gjitha rastet me shprehjet e zgjedhura në deklarime si: 'para cash të siguruara nga kursimet familjare', 'para cash', 'lekë cash', apo 'gjendje cash', terma këto të përdorura në dpv-të vit pas viti, kam nënkuptuar dhe dashur të shpreh kursimet vjetore familjare për vitin përkatës.

Kërkoj mirëkuptimin tuaj dhe rishikimin e përlllogaritjeve të kryera mbi situatën time financiare duke marrë në konsideratë sa deklaruar më lart, dpv-në e vitit 2014 dhe, gjithashtu, duke mbajtur parasysh mangësitë financiare, çka mund të ketë çuar në përzgjedhjen jo të duhur të termave financiare për të përshkruar gjendjen e kursimeve vjetore.

Më poshtë po pasqyroj gjendjen progresive vit pas viti nga periudha 2004-2016 të gjendjes cash, sipas deklarimeve vjetore periodike.

Sipas tabelës gjendja cash është pakësuar në vlerën 6,000,000 lekë, në vitin 2016, për kontratën e huas me qëllim kalimin në të ardhmen në favorin tim si palë huadhënëse pronësinë e një apartamenti që do të ndërtohet nga huamarrësi në truallin me sip. totale 1873.15 m² në pronësi të familjeve B, Xh e Sh.

Për sa më sipër, i kërkoj komisionit rianalizimin e gjendjes cash të deklaruar nga unë në vitet 2013 – 2016.

Konkluzioni i Komisionit se nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së huas, unë jam përpjekur të fsheh qëllimin e vërtetë të këtij transaksioni nuk është i drejtë pasi pikërisht në nenin 1 'objekti', përcaktohet se: 'Pala huamarrëse deklaron se, ka marrë prej palës huadhënëse shumën prej

50,000 euro, me qëllim kalimin në të ardhmen të pronësisë në favor të palës huadhënëse të një apartamenti që do të ndërtohet në të ardhmen nga Huamarrësi në truallin me sipërfaqe totale 1873.15 m² ndodhur në Tiranë, z. k. ***....

Arsyeja, se përse nuk është bërë direkt kontratë porosie apartamenti, është se shoqëria “***” sh.p.k., në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate nuk e kishte nxjerrë akoma lejen e ndërtimit, si dhe në rast se shoqëria “***” sh.p.k., nuk do të arrinte të pajisej me leje ndërtimi atëherë nëpërmjet kontratës së huas e kam vlerësuar ta bëj në këtë formë që të përbënte titull ekzekutiv, me qëllim për të garantuar sa më shpejt kthimin e shumës së dhënë hua.

Pjesë përbërëse e kontratës së huas së datës 31.12.2016 janë edhe kontratat e sipërmarrjes mes pronarëve të truallit dhe shoqërisë “***”sh.p.k., për vënien në dispozicion të truallit me qëllim zhvillimin e kësaj prone.

Shoqëria “***”sh.p.k. është pajisur me leje ndërtimi nr. *** prot., miratuar me vendim nr. ***, datë 14.6.2017, të Kryetarit të Bashkisë një kopje të së cilës po jua vë në dispozicion.

Vlera e llogaritur nga Komisioni është bërë në kundërshtim me aktet ligjore, pasi ka marrë për bazë një vlerë më të lartë se ajo që i korrespondon zonës ku ndodhet objekti.

Fakti i dhënies së shumës prej 50,000 euro e shoqërisë “***”sh.p.k., nga unë provohet në nenin 2 të kontratës të datës 31.12.2016, se pagesa është bërë jashtë kësaj zyre noteriale. Kjo formë pagese ka qenë në përputhje me ligjin e kohës në fuqi dhe pagesa merret e mirëqenë e kryer sipas kontratës së firmosur. Kontrata është konsideruar si një nga format që parashikon ligji i kohës në fuqi për mënyrën e pagesës së huas”.

Vlerësimi i Komisionit

7.16 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, sqaroi qëllimin e kontratës së dhënies hua të shumës 50,000 euro shtetasit Q.D, që është pagesa për porosinë e një apartamenti pas dy vitesh. Subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë porosie duke e trajtuar si kontratë huaje. Ky veprim nuk ka pasoja juridike, por në kushtet e një gjyqtari është e papranueshme dhe një gjë e tillë, duke çuar kështu në cënimin e figurës së tij si gjyqtar.

7.17 Pavarësisht se subjekti nuk solli asnjë dokumentacion provues (transaksion banke, mandat ose ndonjë formë tjetër të parashikuar nga ligji) që vërteton dhënien e shumë prej 50,000 euro shoqërisë “***” sh.p.k., në vitin 2016, Komisioni mori të mirëqenë faktin e pagesës jashtë zyrës noteriale, siç ka shpjeguar.

7.18 Ndërsa, në lidhje me vlerësimin e Komisionit mbi shpjegimet që subjekti jep në analizën progresive të kursimeve *cash*, referojuni vlerësimit të Komisionit te kreu “*deklarime cash*”.

7.19 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për dhënien e huas në shumën 50,000 euro, në vitin 2016, pasi subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë në pamundësi financiare në vlerën 4,577,800 lekë, për vitin 2016 Kjo pamundësi ndryshon nga vlera e

rezultateve, për shkak të mospërfshirjes në analizë të të ardhurave të bashkëshortes së subjektit në shoqatën “***”¹⁰.

7.20 Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas në shumën 50,000 euro, në vitin 2016, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

8. Llogari rrjedhëse në emër të subjektit Rexhep Karaj

8.1 Subjekti ka deklaruar llogari bankare nga paga në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 1,301,068 lekë. Pjesa takuese: 100%.

8.2 Bazuar në dokumentin “nxjerrje llogarie”, në datën 26.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, konfirmohet se subjekti zotëron shumën 1,301,066 lekë.

8.3 Gjendja e llogarisë së deklaruar nga subjekti, vërtetohet edhe me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, të “Raiffeisen Bank”, ku konfirmohet se shtetasi Rexhep Karaj ka llogari page me gjendje 1,301,066 lekë, në datën 30.1.2017.

8.4 Komisioni doli me konkluzionin se nuk kishte problematika për këtë llogari page me gjendje 1,301,066 lekë, në datën 30.1.2017 dhe rezultoi se subjekti ka deklaruar saktë këtë llogari.

9. Llogari rrjedhëse në emër të shtetasit Rexhep Karaj në “Raiffeisen Bank”

9.1 Subjekti ka deklaruar llogari bankare në shumën 41,523.85 lekë sipas nxjerrjes së llogarisë në datën 23.1.2017, ku vërtetohet kjo shumë gjendje në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese: 100%

9.2 Bazuar në dokumentin “nxjerrje llogarie”, të Raiffeisen Bank konfirmohet se subjekti zotëron shumën 41,253 lekë.

9.3 Gjendja e deklaruar nga subjekti vërtetohet edhe me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, ku shtetasi Rexhep Karaj ka llogari rrjedhëse me gjendje 41,253 lekë.

9.4 Kjo është një llogari depozite, në të cilën në datën 29.1.2010, depozitohen në total 941,500 lekë. Pas maturimit të kësaj depozite në datën 30.6.1200 tërhiqen nga subjekti 900,000 lekë.

9.5 Nga subjekti nuk deklarohet asnjëherë depozita dhe as burimi i krijimit të saj. Për këtë u pyet subjekti në pyetësorin nr. 3.

9.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar nga Komisioni¹¹.

9.7 Duke qenë se subjekti nuk ktheu përgjigje pyetësorit të Komisionit, lidhur me burimin e depozitimit të vlerës prej 941,500 lekë dhe përdorimin e vlerës së tërhequr prej 900,000 lekësh, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime.

9.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Burimi i depozitës me vlerë 941,000 lekë përbëhet nga kursimet e mia familjare, gjendje cash dhe në llogari bankare.*

¹⁰Shihni metodologjinë lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit T. K te “***”, në pikën 23 të këtij vendimi.

¹¹Shihni konstatimet e bëra nga Komisioni në pikën 2.10 më sipër në këto rezultate hetimi.

Ndërsa shumë prej 900,000 lekësh e kam tërhequr për t'u pasur si gjendje cash dhe kjo tërheqje cash e parave është shtuar përsëri në gjendjen cash të kursimeve progresive. Nuk është deklaruar si depozitë sepse është hapur depozita dhe është mbyllur brenda vitit”.

Vlerësimi i Komisionit

9.9 Shpjegimet e subjektit lidhur me këtë llogari ishin bindëse dhe nuk rezultoi problematikë lidhur me këtë pasuri.

10. Llogari rrjedhëse në emër të bashkëshortes së subjektit T.K, në “Credins Bank”

10.1 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare në vlerën 140,604 lekë. Pjesa takuese: 100%.

10.2 “Credins Bank”, dega Burrel, vërteton dhe konfirmon se T.K është kliente e kësaj banke dhe se ka gjendje në llogari shumë 140,604 lekë.

10.3 Komisioni arriti në rezultatin se nuk konstatohen problematika për llogarinë e pagës të “Credins Bank”, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

11. Llogari rrjedhëse në emër të bashkëshortes së subjektit T. K, në “Raiffeisen Bank”

11.1 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare në vlerën 5,487 euro. Pjesa takuese: 100%.

11.2 Sipas deklarimit dhe konfirmimit të bërë nga “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, bashkëshortes së subjektit T.K ka llogari rrjedhëse me gjendje në vlerën 5,487 euro, në datën 30.1.2017.

11.3 Në këtë llogari transferohen pagat që bashkëshortja e subjektit merr si koordinatore në shoqatën “***”.

11.4 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj llogarie, referojuni metodologjisë së të ardhurave të bashkëshortes së subjektit në shoqatën “***”¹².

12. Llogari rrjedhëse në emër të bashkëshortes së subjektit T.K në “Raiffeisen Bank”

12.1 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare vlerën 3,194 lekë. Pjesa takuese: 100%.

12.2 Sipas deklarimit të bërë dhe konfirmimit të bërë nga “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, T.K ka llogari rrjedhëse me gjendje në vlerën 3.194 lekë, në datën 30.1.2017.

12.3 Kjo është një llogari depozite, në të cilën në datën 30.12.09 depozitohen në total 767,774 lekë. Pas maturimit të kësaj depozite në datën 23.4.10 tërhiqen nga bashkëshortja e subjektit 770,000 lekë.

¹²Shihni metodologjinë, lidhur me të ardhurat, në pikën 23 të këtij vendimi.

12.4 Nga subjekti nuk deklarohet asnjëherë depozita dhe as burimi i krijimit të saj. Gjithashtu, nuk deklarohet as përdorimi i këtyre parave pas tërheqjes së shumës 770,000 lekë. Për këtë u pyet subjekti në pyetësin nr. 3.

12.5 Në përgjigje të pyetorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar nga Komisioni¹³.

12.6 Për këtë shkak, lidhur me burimin e depozitimit të vlerës 767,774 lekë dhe përdorimin e vlerës së tërhequr prej 770,000 lekësh, subjekti u ftua të japë shpjegime.

12.7 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Burimi i depozitës me vlerë 767,774 lekë përbëhet nga kursimet tona familjare, gjendje cash dhe në llogari bankare. Ndërsa shumën prej 770,000 lekësh e ka tërhequr për ta patur si gjendje cash në familje dhe kjo tërheqje cash e parave është shtuar përsëri në gjendjen cash të kursimeve progresive. Nuk është deklaruar si depozitë sepse është hapur depozita dhe është mbyllur brenda 4 muajve”*.

Vlerësimi i Komisionit

12.8 Shpjegimet e subjektit lidhur me këtë llogari ishin bindëse dhe nuk rezultoi problematikë lidhur me këtë pasuri.

13. Llogari rrjedhëse në emër të vajzës së subjektit I.K, në BKT

13.1 Vajza e subjektit I.K ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare shumën 20,101 lekë. Pjesa takuese: 100%.

13.2 Sipas deklarimit të bërë dhe konfirmimit të bërë nga BKT me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2017, I.K ka llogari rrjedhëse me gjendje në vlerën 20,101 lekë, në datën 29.1.2017.

13.3 Komisioni nuk konstatoi problematika për llogarinë e pagës te BKT në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit.

14. Llogari rrjedhëse në emër të djalit të subjektit A.K, në “Credins Bank”

14.1 I biri i subjektit A.K ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare shumën 7,130 lekë. Pjesa takuese: 100%.

14.2 Sipas deklarimit të “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2017, konfirmohet se A.K ka gjendje në llogari shumën 7,130 lekë. Konfirmohet nga banka se kjo është llogari në cilësinë e person fizik “A.K”.

14.3 Komisioni nuk konstatoi problematika për llogarinë e pagës te “Credins Bank”, në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit.

15 Llogari rrjedhëse në emër të djalit të subjektit A.K, në “Credins Bank”

15.1 I biri i subjektit A.K ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare shumën 1,370 lekë. Pjesa takuese: 100%.

¹³Shihni konstatimet e bëra nga Komisioni në pikën 2.10 më sipër në rezultatet e hetimit.

15.2 Sipas deklaramit të “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2017, konfirmohet se A. K ka llogari *Visa Prepaid*, me gjendje në vlerën 1.370 lekë, në datën 29.1.2017.

15.3 Komisioni nuk konstatoi problematika për llogarinë e pagës të “Credins Bank”, në emër të djalit së subjektit të rivlerësimit.

16 Llogari rrjedhëse në emër të vajzës së subjektit E.K, në “Raiffeisen Bank”

16.1 E bija e subjektit E.K ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare shumë -119,631 lekë debi *overdrafti*. Pjesa takuese: 100%.

16.2 E.K deklaroi gjendjen e detyrimit të *overdraft* në shumë -119.631 lekë.

16.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresën *** prot., datë 10.7 2017, konfirmon se E.K ka llogari page (*overdraft*) me gjendje në shumë -133,146 lekë.

16.4 Subjekti ka paraqitur dokumentacion për gjendjen e datës 27.1.2017, ndërsa përgjigja e bankës i referohet gjendjes së datës 30.1.2017.

16.5 Komisioni nuk konstatoi problematika për llogarinë e pagës të “Raiffeisen Bank”, në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit.

Konstatime të tjera

17 Automjet tip “Fiat Punto”, viti i blerjes 2013

17.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, subjekti ka deklaruar blerje automjeti tip “Fiat Punto”, në vlerën 150,000 lekë.

17.2 DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2020, konfirmon se I. K, ka regjistruar automjetin, me targa AA *** GO, për periudhën 29.5.2013 – 10.8.2015.

17.3 Bazuar në dokumentin e përcjellë nga DPSHTRr-ja, rezultoi një deklaratë në gjuhën italiane ku evidentohet vlera 300 euro e automjetit, si çmim për blerjen e tij. Bazuar në deklaratën doganore, datë 9.4.2013, rezultoi se vlera e referencës për këtë automjet është 271,697 lekë, si dhe rezultoi pagimi i detyrimit doganor në vlerën 54,338 lekë.

17.4 Sa më sipër, nuk disponohet një kontratë noteriale për blerjen e automjetit, çka vuri në dyshim edhe vlerën reale të tij.

17.5 Analiza financiare

Në analizë financiare është përfshirë si çmim blerjeje vlera 150,000 lekë, sipas deklaramit të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013.

Nga analiza financiare, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës, në vlerën 286,793 lekë.

Si rrjedhim, në analizën financiare, nuk u konsideruan të ligjshme as të ardhurat e deklaruara nga shitja e këtij automjeti në vitin 2014.

17.6 Komisioni, në përfundim të hetimeve, konkludoi se:

- a) Nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i blerjes së automjetit tip “Fiat Punto”, në vitin 2013, për shkak të pamjaftueshmërisë financiare në vlerën 286,793 lekë.
- b) Subjekti duhet të japë shpjegime për vlerën reale të blerjes së automjetit, si dhe përse ky automjet është shitur më pas më shumë se çmimi i blerjes.
- c) Ka mungesë dokumentacioni ligjor për blerjen e automjetit (mungon kontrata e blerjes).

17.7 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

17.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: “Automjeti ‘Fiat Punto’ është blerë nëpërmjet aktit të shitjes që është “deklarim gjuhën italiane viti 2013”, i cili ka shërbyer si akt për zhdoganimin e automjetit nga Italia për në Shqipëri direkt në emrin tim Rexhep Karaj, si dhe ka shërbyer si akt për regjistrimin e automjetit në DPSHTRR.

Sa i takon vlerës reale të automjetit, deklaroj se kam, blerë një makinë të përdorur prej 12 vitesh, pasi makina tip ‘Fiat Punto’ është viti i prodhimit viti 2001, shumë e amortizuar kishte dëmtime, si dhe nevojë për riparime. Makinës i kam bërë shërbime të nevojshme, të cilat së bashku me vlerën e zhdoganimit prej 54,388 lekësh, çmimi i blerjes 300 euro, në total kapin vlerën 150,000 lekë, sa deklaruar në deklaratën vjetore 2013, pa dhënë detajet më sipër.

Gjendja financiare është e mjaftueshme për blerjen e automjetit ‘Fiat Punto’, kjo referuar uljes së shpenzimeve të udhëtimit gjatë vitit 2013, ku të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi janë mbuluar nga personi pritës në Itali, nga kushërira ime.

Gjendjen financiare të mundshme e gjeni të shpjeguar në seksionin e analizave financiare vjetore”.

17.9 Pas shpjegimeve të subjektit, Komisioni hartoi një analizë të re financiare për shkak të mospërfshirjes së të ardhurave të bashkëshortes së subjektit në shoqatën “***”¹⁴.

17.10 Subjekti pretendoi zbritje shpenzimesh udhëtimi te analiza e mundësisë së blerjes së automjetit, por nuk dokumentoi mbulimin e kostove të qëndrimit pranë familjarëve të tij në Itali. Si rrjedhim, këto shpenzime udhëtimi nuk janë zbritur te shpenzimet totale të udhëtimit.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit “Fiat Punto”, në datën 3.4.2013

| Përshkrimi | Vlera |
|---|----------------|
| Të ardhura Rexhep Karaj, 1.1.2013 - 3.4.2013 | 441,342 |
| Të ardhura T.K tek Zyra Arsimore Mat, 1.1.2013 - 3.4.2013 | 118,848 |
| Të ardhura E.K, 1.1.2013 - 3.4.2013 | 191,995 |
| Të ardhura totale 1.1.2013 - 3.4.2013 | 752,185 |
| Shpenzime jetese, 1.1.2013 - 3.4.2013 | 176,280 |
| Shpenzime udhëtimi, 1.1.2013 - 3.4.2013 | 301,452 |

¹⁴Shihni metodologjinë lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit T.K te “***”, te pika 23 e këtij vendimi.

| | |
|---|-----------------|
| Blerje automjeti, datë 3.4.2013 | 150,000 |
| Shpenzime totale 1.1.2013 - 3.4.2013 | 627,732 |
| Ndryshim likuiditeti, 31.12.2012 - 3.4.2013 | 450,904 |
| Pamundësi kursimi | -326,451 |

Vlerësimi i Komisionit

17.11 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit tip “Fiat Punto”, në vitin 2013.

17.12 Si rrjedhim edhe të ardhurat nga shitja e këtij automjeti nuk janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2014.

18. Marrje huaje në vlerën 4,000 euro

18.1 Në deklaratën e interesave privatë periodike/vjetore të vitit 2004, subjekti ka deklaruar “4,000 euro në përdorim të nipit V.A”.

18.2 Në deklaratën e interesave privatë periodike/vjetore të vitit 2006 është deklaruar shlyerja e këtij detyrimi.

18.3 Në ILDKPKI është administruar një deklaratë e thjeshtë ku shtetasi V.A, nipi i subjektit, përpara 10 vjetësh i ka dhënë z. Rexhep Karaj shumën 4,000 euro hua, të cilën ia ka kthyer.

18.4 Nga hetimi rezulton se subjekti nuk ka deklaruar mundësitë financiare të nipit V.A për dhënien e kësaj huaje në shumën 4,000 euro, si dhe mundësitë e shlyerjes nga ana e tij.

18.5 Për këtë, i është kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me mundësitë financiare të dhënies së kësaj shume nga nipi V.A.

18.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “*Deklaroj me përgjegjësi të plotë se jo vetëm nipi im V.A, por edhe dy nipat tjerë, që nga fillimi i viteve '90 e deri më sot punojnë si emigrantë ekonomikë në shtetin grek. Deri në fund të vitit 2000 kanë punuar pa dokumente, por që nga viti 2001 punojnë me dokumente të rregullta*”.

18.7 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte mundësinë financiare të huadhënies nga shtetasi V.A të shumës 4,000 euro hua, të cilën deklaroi se ia ka kthyer në vitin 2006.

18.8 Në përfundim të hetimeve rezultoi mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetasit V.A për dhënien e huas prej 4,000 euro në vitin 2004 dhe, si e tillë, kjo shumë nuk u bë pjesë e analizës financiare, për sa kohë nuk kishte burim të ligjshëm.

18.9 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

18.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Nipi V.A ka një gjendje financiare shumë të mirë, të arritur në sajë të punës së tij në emigracion në Greqi, që prej vitit 1992 dhe të ardhurat e tij janë të ligjshme, pasi është emigrant i rregullt që prej vitit 2001”.*

Vlerësimi i Komisionit

18.11 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mundësinë financiare të shtetasit V.A për dhënien e huas prej 4,000 euro në vitin 2004 dhe përfundimisht kjo shumë nuk u bë pjesë e analizës financiare, për sa kohë nuk kishte burim të ligjshëm.

18.12 Komisioni vlerësoi se as kthimi i kësaj huaje nuk do jetë pjesë e analizës financiare meqenëse nuk u vërtetua burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj vlere nga huadhënësi, por edhe për arsye se kjo vlerë nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti i rivlerësimit.

19. Shpenzime qiraje për fëmijët

19.1 Subjekti i rivlerësimit u pyet në pyetësonin nr. 2 nëse ka përdorur prona të regjistruara në emër të dikujt tjetër dhe, nëse po, të tregojë pasurinë e përdorur dhe periudhën e përdorimit.

19.2 Në përgjigje të tij, subjekti deklaroi se: *“Kam përdorur dy banesa që janë pasuri e të tjerëve, njëra banesë në pronësi të shtetasit R.Ll dhe tjetra në pronësi të Xh.A. Banesa 2+1 në pronësi të shtetasit R.Ll ndodhet në rrugën ‘***’ dhe është përdorur nga fëmijët e mi dhe të tjerë nga viti 2008 deri në vitin 2012. Banesa 2+1 në pronësi të Xh.A, e cila ndodhet në Tiranë, është përdorur nga fëmijët e mi dhe të tjerë nga viti 2012 dhe aktualisht”.*

19.3 Në përgjigje të pyetjes për pagesën e qirasë së banesës në rrugën “F.Xh”, subjekti ka deklaruar se: *“Në vitin 2008 fëmijët e mi kanë filluar studimet në Tiranë dhe kam marrë me qira banesën e R.Ll me marrëveshje verbale. Në vitin 2011 kam nënshkruar edhe një kontratë qiraje me qiradhënësin, ku kam paguar 10,000 lekë në muaj, ndërsa dy të tjerët 5,000 lekë, gjithsej 15,000 lekë.*

Në lidhje me banesën e dytë në pronësi të Xh.A, deklaroj se ky është kunati im dhe me të kam marrëveshje verbale që likuidimi i qirasë të bëhet në momentin e lirit të banesës”.

19.4 Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të mjaftueshëm, ai u pyet përsëri se kur është liruuar apartament i marrë me qira dhe sa kanë qenë shpenzimet vjetore për përdorimin me qira të kësaj pasurie për secilin vit përkatës.

19.5 Në përgjigje të pyetësonit nr. 3, subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar.

19.6 Në analizën financiare janë përfshirë shpenzime e qirasë të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësonit për vitet 2008 - 2012.

19.7 Duke qenë se subjekti nuk i ka kthyer përgjigje pyetësonit të Komisionit, në përfundim të hetimeve iu kërkua të japë shpjegime se kur është liruuar apartamenti i marrë me qira dhe sa kanë qenë shpenzimet vjetore për përdorimin me qira të kësaj pasurie për secilin vit përkatës.

19.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se *apartamenti nuk është liruar dhe për këtë arsye nuk ka akoma shpenzime qiraje për përdorimin e këtij apartamenti.*

Vlerësimi i Komisionit

19.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk ka dhënë shpjegime shteruese në lidhje me shpenzimet e mundshme të kryera. Nuk ekziston asnjë dokumentacion që të provojë pagesë qiraje për këtë periudhë. Për pasojë, në analizën financiare nuk janë llogaritur shpenzime qiraje për periudhën e përdorimit të kësaj pasurie.

19.10 Subjekti nuk e ka deklaruar saktë në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting* pasurinë në përdorim, vlerën e saj dhe shpenzimet e kryera për vitet në përdorim. Subjekti ka pasur detyrim të deklarojë saktë pasuritë në pronësi, zotërim dhe përdorim, gjë që nuk e ka bërë, kjo sipas pikës 11, të nenit 3 dhe të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

20. Shpenzime shkollimi për vajzat për vitet 2000 - 2005

20.1 Me vërtetimin nr. ***, datë 18.2.2015, të institucioneve arsimore “****” vërtetohet se vajza e subjektit E.K ka qenë nxënëse e kësaj shkolle përgjatë viteve 2000 - 2004 dhe vajza I.K përgjatë viteve 2001 - 2005.

20.2 Referuar deklaratave të interesave private vjetore të viteve 2003 - 2005, subjekti nuk ka deklaruar shpenzime shkollimi.

20.3 Ndërsa në përgjigjen e pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *“Dy nga fëmijët e mi, E dhe I.K, kanë kryer arsimin parauniversitar (të mesëm) në kolegjin turk ‘***’, Tiranë, me kosto mujore 120 USD në muaj, ku përfshiheshin tarifa e shkollimit, akomodimit dhe ushqimit njëkohësisht”.*

20.4 Për shkak të paqartësisë dhe mungesës së deklaramit të mundësisë financiare, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor të pagesës së bërë pranë këtij institucioni arsimor privat dhe të provojë mundësitë financiare të pagesës së shkollimit të vajzave.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Dua të theksoj se mosdeklarimi i shpenzimeve për shkollim mund të ketë ndodhur thjesht për arsye të mosdijes për ta bërë këtë gjë.*

Në lidhje me dokumentacionin ligjor të shpenzimeve, unë i jam drejtuar disa herë atij institucioni, por kam marrë si përgjigje, që ‘institucioni ynë nuk disponon të dhëna për sa i përket pagesave të kryera nga ana e prindit për periudhën e mësipërme’.

Në lidhje me mundësitë financiare për kryerjen e këtyre pagesave, deklaroj se ata kanë qenë plotësisht të mundura, sepse kane qenë pagesa të arsyeshme dhe të përballueshme nga ana e familjes tonë”.

20.5 Në analizën financiare, shpenzimet e shkollimit tek ky institucion janë përfshirë sipas përgjigjes së subjektit në pyetësorin standard.

20.6 Në përfundim të hetimeve, rezultoi se mbetet e paprovuar nga subjekti vlera e saktë e shpenzuar për shkollimin e fëmijëve pranë kolegjit turk “****”, Tiranë.

20.7 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

20.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Në lidhje me vlerën e saktë të shpenzimeve për shkollimin e fëmijëve pranë institucionit arsimor, kolegji turk ‘***’, Tiranë, i jam drejtuar shkresërisht disa herë këtij institucioni, por përgjigjja e tyre është se nuk disponojmë të dhëna për sa i përket pagesave të kryera për periudhën e kërkuar. Objektivisht nuk kam mundësi tjetër, përveç sa deklaruar pagesa mujore 120 USD në muaj”.*

Vlerësimi i Komisionit

20.9 Në lidhje me shpenzimet e studimit të vajzave pranë kolegjit turk “****”, Tiranë, subjekti nuk solli përgjigje shteruese shtesë në krahasim me atë se çfarë kishte sjellë më parë, duke qenë se nuk ka informacion për ato vite nga institucioni.

20.10 Informacioni i vetëm është vërtetimi i lëshuar nga institucioni arsimor “****”, që dëshmon ndjekjen e studimeve nga vajzat e subjektit në vitet 2000 - 2005, por pa deklaruar tarifat përkatëse.

20.11 Ndërkaq, subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar kosto mujore 120 USD/muaj, ku përfshiheshin tarifa e shkollimit, të akomodimit dhe të ushqimit.

20.12 Në këto kushte, në analizën financiare, këto vlera të deklaruara nga subjekti janë konsideruar si shpenzime shkollimi për fëmijët përgjatë viteve 2000 - 2005.

21. Deklarimi i kursimeve cash

21.1 Deklarimi i subjektit dhe vlerësimi

- Në DPV/2003 subjekti nuk deklaron kursime cash.
Gjendja e konsideruar nga Komisioni në fund të vitit 2003 në analizën financiare është 0 (zero).
- Në DPV/2004, subjekti deklaron: *“Gjendje cash të nipit emigrant – 4,000 euro – 100 %, si dhe gjendje cash – 500,000 lekë – 100 % - (krijimi 1998 – 2004)”.*
- Në DPV/2005, subjekti deklaron: *“Lekë cash – 500,000 – 100 %”.*
- Në DPV/2006, subjekti deklaron: *“Për vitin 2006 kam kursyer (shtim të ardhurash) – 300,000 lekë – 100 %, si dhe kam shlyer një borxh të marrë nga nipi im V.A, të marrë disa vite më parë – 4,000 euro”.*
- Në DPV/2007, subjekti deklaron: *“Kursime nga të ardhurat – 150,000 lekë – 100 %”.*
- Në DPV/2008 subjekti nuk deklaron kursime cash.
- Në DPV/2009, subjekti deklaron: *“Të ardhura 600,000 lekë nga kursimet e të ardhurave familjare”.*
- Në DPV/2010, subjekti deklaron: *“Para cash – 500,000 lekë – 100 %”.*
- Në DPV/2011, subjekti deklaron: *“Para cash të siguruara nga kursimet familjare – 1,000,000 lekë – 100 %”.*
- Në DPV/2012, subjekti deklaron: *“Para cash të siguruara nga kursimet familjare – 1,200,000 lekë – 100 %”.*

- Në DPV/2013, subjekti deklaron: “Para cash të siguruara nga kursimet familjare – 1,300,000 lekë – 100 %”.
- Në DPV/2014, subjekti deklaron: “Gjendje cash – 800,000 lekë – 100 %”.
- Në DPV/2015, subjekti deklaron: “Gjendje cash jashtë sistemit bankar dhe në llogaritë rrjedhëse familjare, të siguruara nga kursimet familjare – 1,700,000 lekë – 100 %”.
- Në DPV/2016, subjekti deklaron: “Gjendje cash jashtë sistemit bankar dhe në llogaritë rrjedhëse familjare, të siguruara nga kursimet familjare për vitin 2016 – 1,500,000 lekë – 100 %”.

Gjendja e llogarive bankare në fund të vitit 2016 rezulton në shumën 1,483,944 lekë¹⁵.

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Gjendje e parave në cash = 1,250,000 lekë – 100 %”.

Gjendja e kursimeve *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting* nuk përputhet me gjendjen progresive të llogaritur deri në këtë moment të këtyre kursimeve në analizën financiare. Megjithëse subjekti është pyetur në pyetësonin nr. 3 edhe për sqarimin e ndryshimeve të kursimeve *cash* në vitin 2017, nuk ka kthyer përgjigje. Mbetet kështu e paprovuar mundësia financiare e subjektit për krijimin e kursimeve *cash* në vlerën 1,250,000 lekë në datën 29.1.2017 dhe depozitimit të vlerës prej 700,000 lekësh në llogarinë e tij të pagës në datën 27.1.2017 (2 ditë para dorëzimit të deklaratës *Vetting*).

21.2 Subjekti është pyetur lidhur me saktësimin e kursimeve *cash* në fund të secilit vit (shitesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar), për periudhën 2004 – 2017.

Në lidhje me pyetësonin nr. 3, subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar nga Komisioni.

Analiza progresive e kursimeve *cash* bazuar në deklaratimet periodike të subjektit¹⁶

| Viti | Shtesa | Pakësime | Totali progresiv |
|------|-----------------------|----------------|-------------------------|
| 2003 | 0 | | 0 |
| 2004 | 500,000 lekë + 4,000€ | | 500,000 lekë + 4,000€ |
| 2005 | 500,000 leke | | 1,000,000 lekë + 4,000€ |
| 2006 | 300,000 lekë | 4,000€ | 1.300,000 lekë |
| 2007 | 150,000 lekë | | 1.450,000 lekë |
| 2008 | 0 | | 1.450,000 lekë |
| 2009 | 600,000 lekë | | 2,050,000 lekë |
| 2010 | 500,000 lekë | | 2.550,000 lekë |
| 2011 | 1,000,000 lekë | | 3,550,000 lekë |
| 2012 | 1,200,000 lekë | | 4,750,000 lekë |
| 2013 | 1,300,000 lekë | | 6,050,000 lekë |
| 2014 | | 5,520,000 lekë | 800,000 lekë |
| 2015 | | 800,000 lekë | 0 |
| 2016 | | | 0 |

¹⁵Këtu përjashtohet llogaria bankare me *overdraft* në emër të vajzës së subjektit E.K tek “Raiffeisen Bank” meqenëse është me gjendje negative.

¹⁶Analiza progresive në këtë tabelë është bërë nga Komisioni.

21.3 Duke qenë se subjekti nuk i ktheu përgjigje pyetësorit të Komisionit në lidhje me dokumentacionin provues të kërkuar, në këto rrethana, Komisioni u bazua vetëm në provat dhe faktet e administruara dhe arriti në konkluzionin se ka mospërputhje midis gjendjes së kursimeve të deklaruara në deklaratën *Vetting* me gjendjen progresive të llogaritur të kursimeve në tabelën më lart nga subjekti i rivlerësimit.

21.4 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen e likuiditetit në bankë sipas dokumentacionit të administruar nga bankat.

21.5 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

21.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Siç ka deklaruar edhe më sipër, në shpjegimet e dhëna për kontratën e datës 31.12.2016, përsërisim se ka një vlerësim të gabuar nga Komisioni mbi DPV-në e vitit 2014 sa i takon gjendjes cash, pasi gjendja cash prej 800,000 lekësh nuk është konsideruar si shtesë në gjendjen cash nga kursimet vjetore familjare, siç është bërë normalisht për periudhën 2004 – 2013, duke e konsideruar gjendjen cash prej 800,000 lekësh si gjendje totale progresive të cash-it. Gjatë vitit 2014 rezulton që nuk është bërë asnjë shpenzim në vlerën prej 5,250,000 lekësh, siç Komisioni ka pakësuar kursimet cash. Prandaj gjendja cash prej 800,000 lekësh, e deklaruar në DPV/2014, duhet t’i shtohet kursimeve cash progresive deri në vitin 2013, duke paraqitur gjendje të kursimeve cash deri në datën 31.12.2014, prej 6,850,000 lekësh.*

Në mënyrë progresive paraqitet tabela e kursimeve cash për periudhën 2003 – 2016.

Analiza progresive e kursimeve cash bazuar në deklaratimet periodike të subjektit

| Viti | Shtesa | Pakësime | Total progresiv |
|-------------|-----------------------|-----------------|-------------------------|
| 2003 | 0 | | 0 |
| 2004 | 500,000 lekë + 4,000€ | | 500,000 lekë + 4,000€ |
| 2005 | 500,000 leke | | 1,000,000 lekë + 4,000€ |
| 2006 | 300,000 lekë | 4,000€ | 1.300,000 lekë |
| 2007 | 150,000 lekë | | 1.450,000 lekë |
| 2008 | 0 | | 1.450,000 lekë |
| 2009 | 600,000 lekë | | 2,050,000 lekë |
| 2010 | 500,000 lekë | | 2.550,000 lekë |
| 2011 | 1,000,000 lekë | | 3,550,000 lekë |
| 2012 | 1,200,000 lekë | | 4,750,000 lekë |
| 2013 | 1,300,000 lekë | | 6,050,000 lekë |
| 2014 | 800,000 lekë | | 6,850,000 lekë |
| 2015 | 0 | 0 | 6,850,000 lekë |
| 2016 | | 6,000,000 lekë | 850,000 lekë |

Ndërsa, sa i takon deklarimeve për gjendjen e likuiditetit në bankë, duke qenë se këto llogari janë lehtësisht të verifikueshme dhe për shkak të njohurive të mia të pamjaftueshme në aspektin financiar, kam marrë të mirëqenë se ato verifikohen prej jush. Edhe nga 3 kontrollet e njëpasnjëshme nga ILDKPKI-ja nuk më është vënë në pah një gjë e tillë”.

Vlerësimi i Komisionit

21.7 Subjekti, lidhur me shpjegimet që jep tek analiza progresive e kursimeve *cash*, pretendon se gjithmonë ka dashur të deklarojë shtesa të vitit në këto kursime dhe asnjëherë gjendje. Ai shprehet me termat “*para cash të siguruara nga kursimet familjare*”, “*para cash*”, “*lekë cash*” apo “*gjendje cash*”, terma këto të përdorura në deklaratat periodike vit pas viti, ku ka nënkuptuar dhe ka dashur të shprehë kursimet vjetore familjare për vitin përkatës. Po të merret parasysh ky deklaram edhe në vitet 2014 - 2016, subjekti sërish ka dashur të deklarojë shtesat e vitit. Nëse interpretohet në këtë mënyrë, gjendja financiare në total përkeqësohet akoma më shumë sepse kështu gjendja *cash* vetëm shtohet vit pas viti. Kjo bie në kundërshtim me tabelën që sjell subjekti për llogaritjen e kursimeve *cash*. Në këtë tabelë ai pretendon shtim kursimesh prej 800,000 lekësh në vitin 2014, nuk ndryshon kursimet *cash* në vitin 2015 dhe ndërkohë i zvogëlon këto kursime me 6,000,000 lekë në vitin 2016. Këtë zvogëlim e bën për të justifikuar huadhënien prej 50,000 euro ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., por, nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash*. Pra, ai të njëjtën shprehje “gjendje” e interpreton në tri forma të ndryshme për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

21.8 Lidhur me mosdeklarimin e likuiditetit bankar sipas dokumentacionit të administruar, Komisioni në përgjigje sqaron se në vitet 2015 - 2016 gjendja e llogarive bankare nuk është deklaruar në mënyrë të saktë nga subjekti. Shprehja me të cilën subjekti ka deklaruar *gjendjen cash jashtë sistemit bankar dhe në llogaritë rrjedhëse në total*, nuk përputhet me totalin e likuiditeteve bankare të vërtetuara me dokumentacion dhe kursimeve *cash* të pretenduara nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

21.9 Shpjegimet e subjektit në lidhje me kursimet *cash* ishin kontradiktore dhe jo bindëse, duke bërë që Komisioni të mos ndryshojë vlerësimin e këtyre kursimeve në analizën financiare.

21.10 Komisioni, në vlerësimin përfundimtar, i qëndron konkluzionit të rezultateve të hetimit për deklaratat e subjektit për gjendjen *cash* në deklaratat periodike vjetore, bazuar në pikën 5, në nenin 32, të ligjit nr. 84/2016.

22. Analiza financiare

22.1 Komisioni, bazuar në provat dhe faktet e administruara në përfundim të hetimit administrativ, hartoi analizën financiare, pasi subjekti nuk i ktheu përgjigje pyetësorit të Komisionit.

22.2 Nga analiza financiare, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka pasur një pamundësi totale financiare nga fillimi i detyrës deri në vitin 2016 në vlerën 7,877,466 lekë.

22.3 Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

22.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti kërkoi të pasqyrohen në analizën financiare pretendimet, si vijon: “Në analizën financiare, në zërin ‘të ardhura nga pagat subjekti Rexhep Karaj’, në referim të vërtetimeve e pagave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, rezulton se nuk janë paraqitur të plota pagat, shpërblimet dhe dietat për periudhat si vijon: viti 2004 është paga + dieta = total 862,669 lekë; viti 2005 është paga + dieta = total 963,794 lekë; viti 2006 është paga + dieta = total 935,095 lekë; viti 2007 është paga + dieta = total 930,853lekë; viti 2008 është paga + dieta = total 971,850 lekë; viti 2009 është paga + dieta = total 1,270,116 lekë; viti 2010 është paga + dieta = total 1,262,021 lekë; viti 2011 është paga + dieta = total 1,244,175 lekë; viti 2012 është paga + dieta = total 1,253,694 lekë.

Po kështu, nuk janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2004 të ardhurat nga fshati në vlerën prej 300,000 lekësh, sa deklaruar në DPV-në e vitit 2004.

Shpenzimet e mjekimit dhe kontrollit të vazhdueshëm në shtetin italian janë përballuar nga një mik i familjes time, dhe për këtë kërkoh kohë të sjell dokumentacionin provues përkatës, me qëllim që të mos llogariten si shpenzime të bëra nga unë dhe familjarët e mi. Ndërsa shpenzimet spitalore dhe mjekësore janë përballuar nga vetë spitali, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në gjuhën italiane, të përkthyer në shqip.

Ndërsa shpenzimet e udhëtimit gjatë vitit 2013 janë udhëtimet e familjes time në Itali në këtë vit, të cilat janë përballuar nga kushërira ime L.K (D), që jeton në Milano, Itali, dhe për këtë kërkoh kohë të sjell dokumentacionin ”.

Subjekti kërkoi të merret në pyetje shtetasi Q.D, duke qenë se është vënë në diskutim mënyra e kryerjes së pagesës prej 50,000 euro.

Vlerësimi i Komisionit

22.5 Në lidhje me përgjigjet e rezultateve të hetimit të subjektit, referuar pretendimit se nuk janë përfshirë të gjithë të ardhurat e tij nga puna në analizën financiare, duke pretenduar si të ligjshme edhe dietat, Komisioni përgjigjet se dietat nuk përfshihen si të ardhura të ligjshme sepse konsiderohen se janë para që merren për t’u shpenzuar për qëllimin për të cilën janë akorduar.

22.6 Në përgjigje të kundërshtimit nga subjekti për mos përfshirjen e të ardhurave nga fshati në vlerën prej 300,000 lekësh në vitin 2004, Komisioni përgjigjet se subjekti nuk ka paraqitur asnjë lloj evidence për këto të ardhura dhe as burimin e krijimit të tyre.

22.7 Ndërsa, në lidhje me kërkesat e paraqitura me natyrë procedurale nga subjekti i rivlerësimit për marrjen në pyetje të huamarrësit Q.D, me qëllim sqarimin e mënyrës së kryerjes së pagesës prej 50,000 euro, kërkesat e subjektit për t’i dhënë kohë për të sjellë: deklaratën noteriale të shtetasve L.D e L.K në lidhje me shpenzimet e qëndrimit, fjetjes dhe ushqimit për periudhën e qëndrimit në shtetin italian në vitin 2013; deklaratën noteriale të shtetasit T.P, i cili do të deklarojë se *gjatë periudhës së kurimit e në vitet në vijim ka qëndruar e ushqyer te familja e tij*; provat ku të vërtetohet se nipi V.A që nga viti 2000 e në vijim ka qenë i punësuar sipas ligjit grek, kjo për justifikimin e mundësisë financiare për dhënien hua në vitin 2004 të shumës prej 4,000 euro; si dhe dokument të shkruar nga spitali “***” në Milano, i cili

vërteton kurimin e tij pa pagesë në Itali, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesat e subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. 3, datë 4.11.2021, vendosi të refuzojë kërkesat e subjektit të rivlerësimit. Ky vendim i është komunikuar edhe subjektit.

22.8 Analiza financiare

| SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: REXHEP R. KARAJ | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|------------------|------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|
| PERSHKRIMI | Para 2003 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | TOTAL | |
| PASURI | 0 | 0 | 2,111,110 | 1,039,114 | -76,411 | 464,892 | 179,643 | 497,364 | 349,740 | 947,142 | 1,373,926 | 1,947,829 | -4,464,641 | -461,366 | 6,310,652 | 8,854,683 | |
| Apartament Mat 76.17 m2, L. **** - 2007 - 524,608 leke - 83.3% | | | | | 524,608 | | | | | | | | | | | | 524,608 |
| Shtepi dy kate 208 m2+ truall 300 m2, ****, K. - 100% | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Toke bujqesore 36,846 m2, ****, K. - 100% | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Autoveture VW-Golf 3 AA****BO - 2007 | | | | | | 450,000 | | | | | | | | | | | 450,000 |
| Autoveture Mercedes Benz AA***AU - 2010 | | | | | | | | | 762,575 | | | | | | | | 762,575 |
| Autoveture Fiat PUNTO AA***GO - I. K. | | | | | | | | | | | | 150,000 | | | | | 150,000 |
| Autoveture Ford Fiesta AA***KI - 2015 - T.K. & I. K. - 100% | | | | | | | | | | | | | | 204,000 | | | 204,000 |
| Huadhenie shoqerise "*****" - 50,000€ - 2016 | | | | | | | | | | | | | | | 6,763,500 | | 6,763,500 |
| Ndryshim ne likuiditetet ne banke | | | 1,104,150 | 539,114 | -394,059 | -135,108 | 179,643 | -102,636 | -912,835 | -52,858 | 173,926 | 497,829 | 785,359 | 134,634 | -452,848 | | |
| Ndryshim ne likuiditetet ne arke | | 0 | 1,006,960 | 500,000 | -206,960 | 150,000 | 0 | 600,000 | 500,000 | 1,000,000 | 1,200,000 | 1,300,000 | -5,250,000 | -800,000 | 0 | | |
| DETYRIME | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| PASURI NETO (PASURI - DETYRIME) | 0 | 0 | 2,111,110 | 1,039,114 | -76,411 | 464,892 | 179,643 | 497,364 | 349,740 | 947,142 | 1,373,926 | 1,947,829 | -4,464,641 | -461,366 | 6,310,652 | 8,854,683 | |
| TE ARDHURA dokumentuar | 4,381,218 | 875,795 | 1,125,610 | 1,207,999 | 1,286,889 | 1,336,811 | 1,388,377 | 2,250,517 | 2,187,301 | 2,191,797 | 2,268,328 | 2,404,538 | 2,847,155 | 3,030,876 | 3,122,039 | 31,905,250 | |
| Te ardhura nga pagat subjekti Rexhep Karaj | 3,001,386 | 626,167 | 843,669 | 893,194 | 900,295 | 907,053 | 897,850 | 1,188,116 | 1,197,021 | 1,200,175 | 1,253,694 | 1,262,646 | 1,508,973 | 1,464,113 | 1,506,388 | 18,650,740 | |
| Te ardhura nga pagat bashkeshortja T.K. | 1,379,832 | 249,628 | 281,941 | 314,805 | 386,594 | 429,758 | 490,527 | 562,684 | 467,059 | 450,618 | 462,366 | 485,062 | 526,164 | 526,164 | 526,164 | 7,539,366 | |
| Te ardhura nga pagat vajza E. K. | | | | | | | | 499,717 | 523,221 | 541,004 | 552,268 | 656,830 | 731,205 | 729,788 | 671,875 | 4,905,908 | |
| Te ardhura nga pagat vajza I. K. | | | | | | | | | | | | | 80,813 | 310,811 | 346,968 | 738,592 | |
| Te ardhura nga puna djali A. K. | | | | | | | | | | | | | | | 70,644 | 70,644 | |
| Te ardhura nga shitja e automjetit Fiat Punto - 2014 | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| SHPENZIME | 2,999,880 | 1,182,822 | 856,909 | 947,410 | 743,934 | 926,121 | 912,688 | 947,264 | 967,482 | 912,106 | 937,684 | 1,104,095 | 1,292,056 | 1,483,848 | 1,389,187 | 14,603,606 | |
| Shpenzime jetese | 2,143,753 | 563,784 | 563,784 | 657,342 | 657,342 | 819,720 | 819,720 | 819,720 | 819,720 | 683,100 | 697,740 | 705,120 | 1,099,990 | 1,121,380 | 1,175,460 | 13,347,675 | |
| Shpenzime shkollimi vajzat tek shkolla "*****" | 623,126 | 260,856 | 181,594 | 74,398 | | | | | | | | | | | | 1,139,974 | |
| Shpenzime mjekesore | | 133,650 | | | | | | | | | | | | | | 133,650 | |
| Shpenzime mobilimi | 233,000 | | | | | | | | | | 132,000 | | 108,000 | 120,000 | | 593,000 | |
| Shpenzime qiraje femijet ne Tirane 2008 - 2012 | | | | | | | 40,000 | 120,000 | 120,000 | 120,000 | 80,000 | | | | | 480,000 | |
| Shpenzim per license avokatie A. K.- 2015 | | | | | | | | | | | | | | 100,000 | | 100,000 | |
| Shpenzime udhetimi | | 224,532 | 111,531 | 215,670 | 86,592 | 106,401 | 52,968 | 7,544 | 27,762 | 109,006 | 27,944 | 398,975 | 84,066 | 142,468 | 213,727 | 1,809,187 | |
| Analiza dokumentuar | 1,381,338 | -307,027 | -1,842,409 | -778,525 | 619,366 | -54,202 | 296,045 | 805,888 | 870,079 | 332,549 | -43,282 | -647,386 | 6,019,740 | 2,008,394 | -4,577,800 | 2,701,430 | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | Pamundesia financiare totale | -8,250,631 |

Nga analiza financiare, subjekti rezultoi në një pamundësi totale financiare në vlerën 8,250,631 lekë.

23. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë: “Raiffeisen Bank”, BKT, “Credins Bank”, “Union Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: shkollën “Gurrë e Vogël/Gurrë e Madhe” si mësues (vitet 1980 - 1988); Drejtorinë e Policisë Dibër (vitet 1993 - 1995); Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat (vitet 1995 - 2015); si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë (viti 2016).

ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes të subjektit në: shkollën “Gurrë e Vogël/Gurrë e Madhe” si mësuese (vitet 1984 - 1994); shkollën “31 Korriku” Burrel si nëndrejtoreshë (vitet 1994 - 2007); Zyrën Arsimore Mat si specialiste (vitet 2007 - 2016).

Lidhur me të ardhurat e deklaruara si koordinatorë pranë shoqatës “***”, vërtetohen që përmes “Raiffeisen Bank” bashkëshortes së subjektit i kanë kaluar përkatësisht vlerat: 900 euro në vitin 2012; 1,500 euro në vitin 2013; 1,650 euro në vitin 2014; 1,415 euro në vitin 2015 dhe 500 euro në vitin 2016.

Nga përgjigjet e ardhura nga ISSH-ja nuk vërtetohet pagesë kontributesh për periudhën e punësimit të deklaruar pranë shoqatës “***” për bashkëshorten e subjektit. Gjithashtu, nga organet tatimore nuk vërtetohet pagesa e tatimit për këto të ardhura në periudhën e deklaruar.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti kërkoi që të paraqiste kontrata të tjera, si dhe të marrë vërtetim se tatimi në burim është paguar nga shoqata “***”, ku bashkëshortja është paguar nga shoqata në shumën 330 euro për punën e saj, por detyrimet janë paguar nga shoqata dhe në bankë i ka kaluar shuma 300 euro.

Komisioni vlerëson se të ardhurat e bashkëshortes tek shoqata “***” nuk mund të konsiderohen të ligjshme sepse nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të pretenduara. Në një marrëveshje të paraqitur si provë nga subjekti në përgjigje të rezultateve, në klauzolën 5.3 të saj, përcaktohet se e gjithë përgjegjësia për detyrimet tatimore dhe për sigurimet bie mbi këshilltarin (bashkëshorten e subjektit që do të ofronte shërbime këshillimi sipas marrëveshjes).

Në përfundim, Komisioni nuk përfshin në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit nga shoqata “***”.

iii) Të ardhurat e nënës së subjektit të rivlerësimit nga pensioni (vitet 1982 - 2011)

Subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me këtë shumë të deklaruar, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, paraqiti një vërtetim pensioni, dokument i cili nuk përmbushte elementet e një dokumenti ligjor për nga pikëpamja formale, për shkak të mungesës së ekstremiteve të tij, siç janë emri i institucionit, data, numri i protokollit etj., si dhe është një dokument fotokopje dhe jo origjinal.

Në këto kushte, të ardhurat nga ky dokument nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare të vitit përkatës.

iv) Të ardhurat nga paga të vajzës së subjektit të rivlerësimit E. K si inspektore pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (vitet 2009 - 2016).

v) Të ardhurat nga paga të vajzës së subjektit të rivlerësimit I.K si farmacistë në subjekte private (vitet 2014 - 2016).

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka kërkuar të llogaritet si e ardhur edhe paga e vajzës I.K si farmacistë pranë subjektit person fizik “****”, me NIPT ***, për vitet 2011, 2012 dhe 2013 në shumën 480,000 lekë për secilin vit, kjo edhe sipas deklaratave të këtyre viteve. Formalizimi i marrëdhënies së punës së vajzës me këtë subjekt është bërë në vitin 2016.

Pas vlerësimit nga Komisioni, këto të ardhura nuk u bënë pjesë e analizës financiare për shkak se nuk dokumentohen dhe nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse.

vi) Të ardhura *neto* nga aktiviteti privat si avokat i djalit të subjektit të rivlerësimit A. K (viti 2016).

vii) Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Fiat Punto” (viti 2014).

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas përbërjes familjare (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT). Komisioni zbaton një standard të vetëm për shpenzimet e jetesës, pavarësisht vendbanimit.

ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2015, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrimi pranë të afërmeve.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se *bashkëshortja T.K, në datat 24 - 29 nëntor 2013 ka udhëtuar në Itali dhe sipas vërtetimit, datë 27.7.2021, këto shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi janë përballuar tërësisht nga fondacioni “***”.*

Pas vlerësimit të këtij dokumenti, Komisioni bëri zbritjen e këtij shpenzimi nga totali i shpenzimeve të udhëtimit në analizën financiare.

iii) Shpenzime mobilimi të deklaruara nga subjekti (para viteve 2003, 2012, 2014 dhe 2015), të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit.

iv) Shpenzime shkollimi të fëmijëve të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit.

v) Shpenzime qiraje të fëmijëve të subjektit në Tiranë, të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit (vitet 2008 - 2012).

vi) Shpenzime mjekësore (viti 2003) sipas përgjigjeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit. Subjekti pretendon se këto shpenzime janë mbuluar nga shteti italian, por nuk e vërteton këtë plotësisht me dokumentacion.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti kërkoi: *“Në lidhje me shpenzimet për udhëtimet kërkohet të më jepet kohë që të sjell një deklaratë të shtetasve L.D e L.K nga shteti italian. Të më jepni kohë për t’i marrë deklaratë shtetasit T.P, i cili ka mbuluar shpenzimet gjatë kohës së kurimit, ato të qëndrimit, të fjetjes e ushqimit tek familja e tij në Itali. Të më jepet kohë që të paraqes dokument të shkruar nga spitali ‘***’ në Milano, i cili vërteton kurimin tim pranë këtij instituti mjekësor pa pagesë”*.

Komisioni, në përfundim, vlerësoi se subjekti pretendon mbulimin e shpenzimeve mjekësore nga shteti italian, por në prapësime nuk sjell dokument tjetër. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka sjellë një formular aplikimi që nuk vërteton mbulimin e këtyre shpenzimeve. Vlera në analizë është marrë sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard.

vii) Shpenzime për licencë avokati të djalit të subjektit A.K (viti 2015).

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁷.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kriterëve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, ka kryer deklaramit të pasaktë të pasurive dhe të interesave private, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe përdorim.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtar.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit:

- a) Ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë, si dhe duke mos bashkëpunuar me Komisionin siç i është kërkuar.
- b) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2003 – 2016.
- c) Ka bërë deklaramit të pasaktë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm.

¹⁷Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

- d) Ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- e) Nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk i është përgjigjur pyetësorit nr. 3 të dërguar nga Komisioni, si dhe nga veprimet e qëndrimet e tij ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Kështu që, në rastin e subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet e parashikuara në nenin D të Kushtetutës, të parashikuara të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, në lidhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.11.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Firdes SHULI
Anëtare

Amela Idrizi
Sekretare gjyqësore